

Vërja veshin frymëzimit hyjnor!

Namazi

10 sëmundjet që shëron agjërimi

Edukata shpirtërore e një jete të tërë

Mudarebeh - një organizim biznesi!!!

Salih Efendi Myftija

Artet Islame

Të shfletosh
Ramazanin





EDITORIAL

Zoti ynë, ka caktuar në kalendarin e jetës stinët e fitimit shpirtëror në të cilat shpërthejnë ngado mëshira, falja dhe butësia hyjnore në mënyrë që njerëzit të kenë fatin të fitojnë lumturinë e përhershme. Stina më e begatë prej tyre është pa dyshim muaji i bekuar i Ramazanit. Arsyet janë:

- Kurani Fisnik, udhërrëfyesi ynë drejt të vërtetës, u shpall në këtë muaj të bekuar.

- Adhurimi i agjërimit, pretekst për një pjekje shpirtërore të veçantë, është caktuar të kryhet në këtë muaj.

- Nata e Kadrit, që është më e bekuar dhe e vyer sesa një mijë muaj, është dhuruar netëve të Ramazanit.

- Netët dhe mbrëmjet në këtë muaj janë begatuar me anë të namazeve të teravive dhe ngrënies së syfyreve.


- Shpirtrat e plagosur që dridhen mes lloj-lloj nevojash dhe privimesh zhyten më shumë se kurrë në këtë muaj brenda ndjenjave të shpresës dhe gëzimit. Zeqati, sadakaja dhe dhurimi bëjnë që në fytyrat e sa e sa njerëzve të shfaqet sërish buzëqeshja, të cilën kishin vite që nuk e kujtonin.

- Në këtë muaj çelen portat e madhështive shpirtërore dhe dyert e xhenetit.

- Në këtë muaj mbyllen dyert e xhehenemit pasi që njerëzit ruhen më shumë nga gjynahet dhe distancohen më shumë nga kryerja e veprave të këqija.

- Shejtanët dhe ndihmësit e tyre lidhen me vargonjtë e devotshmërisë së njerëzve të përkryer shpirtërisht.

Kështu, muaji i Ramazanit, u hap besimtarëve portat e lumturisë së përjetshme dhe njëkohësisht çel shtigjet e ardhmërisë për mbarë umetin mysliman.





NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

4



16



22



VËRJA VESHIN FRYMËZIMIT HYJNOR!

HASAN KAMIL JËLLMAZ

4

NGA FORMA DREJT TË VËRTETËS

DR. ADEM ERGYL

8

PASOJAT E BRAKTISJES

SË URDHËRIMIT NË TË MIRË

DHE NDALIMIT NGA E KEQJA

FATMIR SULAJ

10

NAMAZI

NAIM DRIAJ

16

10 SËMUNDJET QË SHËRON AGJËRIMI

JONIDA TASHI

19

RREGULLA MBI AGJËRIMIN

EVANS DRISHTI

22

MERITA E MUAJIT TË RAMAZANIT

DR. JUSUF EL-KARDAVI

26

AJETE DHE HADITHE

30

Shtator - Tetor 2009

RAMAZANI I BEKUAR:
EDUKATA SHPIRTËRORE E NJË JETE TË TËRË
OSMAN NURI TOPBASH

32

MUDAREBEH
NJË ORGANIZIM BIZNESI!!!
HAMDI NUHIJU

40

SALIH EFENDI MYFTIJA
ISLAM DIZDARI

46

ARTET ISLAME
50

TEKNOLOGJI
54

SHËNDETI DHE FAMILJA
56

AKTUALITET
58

32



40



50



Viti: III Numri: 20

- Shtator - Tetor 2009
- Ramazan - Sheval 1430

Boton

- Progresi sh.p.k.
- Shkodër / Shqipëri

Përkthyes

- Arjan Ymeri
- Ermal Nurja
- Evans Drishti
- Fatmir Sulaj
- Ilir Hoxha
- Ilir Rruga

Redaktor

- Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik

- Bledar Xama
- bledar_xama@hotmail.com*

Ngjyra

- Progresi

Adresa

- L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
- Shkodër
- Tel: +355 22 254 534
- Fax: +355 22 254 533
- Cel: +355 20 76768 / +355 20 86767

Shtyp

- ArbëriaDesign, Tetovë
- Tel: +389 44 35 33 71
- Fax: +389 44 35 33 72

Për artikuj

- e-mail: revistaetika@progresibotime.com
- e-mail: kosova@progresibotime.com

Çmimi

- 1 Euro
- 150 Lek
- 60 DEN



Vërja veshin frymëzimit hyjnor!

*P*rofeti Musa është një nga profetët e quajtur nga vetë Kurani si ulu'l-adhm. Atij iu shpall libri hyjnor i quajtur Tevrat dhe u cilësua si "kelim" që do të thotë person i pranuar në bashkëbisedimin hyjnor me Allahun. Sipas asaj që mësojmë nga Kurani vetëm Musai është profeti të cilit iu dhurua ky cilësim dhe i vetmi që veçohet me këtë specifikë. Fjala vjen në Kuran profeti Isa është cilësuar si "ruhullah", që do të thotë "frymë nga Zoti", ndërsa profeti Ibrahim si "halilullah" që do të thotë "mik i Zotit".

Sipas asaj që na mëson Kurani drita hyjnore që iu shfaq

në formën e një zjarri profetit Musa i pati thënë këto fjalë kur Musai i qe afruar asaj:

"O Musa! Unë jam Zoti yt! Zbathi këpucët! Ti po qëndron në luginën e shenjtë të Tuva-së. Ti je i përzgjedhuri Im! Tani dëgjo me kujdes atë që do të të shpallet:

- Nuk ka dyshim se Unë jam Allahu që nuk ka zot tjetër përveç Meje.

- Më adhuro vetëm Mua dhe fal namazin që të më përkujtosh.

- Dita e kiametit do të vijë. Dita e tij do të mbetet e panjohur në mënyrë që çdo shpirt

njeriu të fitojë në varësi të gjërave që ju ka shkuar nga pas. Mos të të mashtrojnë ata njerëz që nuk i besojnë kiametit dhe shkojnë pas shijeve dhe qejfeve të tyre, në të kundërt do të jesh i humbur." (Taha, 20/11-16)

Këtë njoftim që mësojmë nga Kurani mund ta vlerësojnë në dy plane:

1- Periudha e përgatitjes për dëgjimin e shpalljes

2- Pjesa e urdhrave hyjnorë.

Në pjesën e parë mësojmë se si përgatitet nga ana e Allahut një pejgamber në mënyrë që ai të bëhet bashkëbisedues shpirt-

ëror me shpalljen hyjnore.

Historia islame na mëson se, pasi u martua me Safurjan, vajzën e profetit Shuajp, profeti Musa u nis bashkë me të shoqen nga Medjeni për në Egjipt ku do të takonte të ëmën dhe vëllain e tij, Harunin. Pasi kishin bërë një copë rrugë të lodhshme, ai pa një dritë që shkëlqente dhe kur u nis drejt saj u prezantua me shpalljen hyjnore. Në pjesën e parë të këtij bashkëbisedimi profeti Musa u përgatit me anën e këtyre fjalëve për shpalljen hyjnore.

a- O Musa! Unë jam Zoti yt!

b- Zbathi këpucët!

c- Ti po qëndron në luginën e shenjtë të Tuva-së.

d- Ti je i përzgjedhuri Im!

e- Tani dëgjo me kujdes atë që do të të shpallet!

Qëllimi i këtij bashkëbisedimi hyjnor jashtëzakonisht tronditës ishte të mundësonte që Musai, tek i cili do të krijohet një efekt ndikues dhe përmbledhës, ta dëgjonte këtë mesazh me veshët e kokës, por me veshët e shpirtit, jo me sytë e ballit, por me forcën e shikimit të brendshëm dhe ta dëgjonte dhe perceptonte thellë në shpirt ato që i thuheshin. Sepse, perceptimi dhe të kuptuarit e saktë dhe të drejtë rreth diçkaje nuk arrihet vetëm duke ja vënë veshin fjalëve që të thuhën, por duke e përqendruar vëmendjen mbi atë pikë.

Të njëjtën mënyrë bashkëbisedimi e shohim edhe tek shpallja që iu drejtua profetit Muhamed. Allahu e njoftoi atë



*Kur të lexohet
Kurani vërjani
veshin atij
dhe heshtni
në mënyrë që
mëshira hyjnore
të zbresë mbi ju*

se do ta ngarkonte me një barrë të rëndë, prandaj e mëson që t'i kalojë netët duke falur namazet e mbrëmjeve (Muze-mil, 73/1-5), sepse gjatë natës vëmendja e njeriut kthehet nga jashtë brenda. Në mbrëmje hapet zemra dhe mendja, organet marrëse punojnë më mirë, prandaj edhe shpallja profetike për profetët dhe frymëzimi poetik për poetët thuhet se është shfaqur të shumtën e rasteve mbrëmjeve. Kurani vë gishtin mbi këtë pikë (Muze-mil, 73/1-5)

Veçanërisht, Allahu e pat urdhëruar profetin tonë që mos ta luante gjuhën shpejt e shpejt në mënyrë që ai ta merrte vahjin sa më shpejt dhe ta memorizonte atë, sepse në këtë mënyrë do të shpërqendrohej, ndërkohe që duhej të përqendrohej në rëndësinë e asaj që i shpallej. (Kijamet, 75/16-17)

Allahu që ua kërkonte këtë kujdes profetëve të Tij, pa dyshim, që të njëjtën shkallë kujdesi kërkon të tregojnë edhe besimtarët e thjeshtë, pasi që në një ajet kuranor thuhet: “Kur të lexohet Kurani vërjani veshin atij dhe heshtni në mënyrë që mëshira hyjnore të zbresë mbi ju” (Araf, 7/204)

Preokupimi i brendshëm i zemrës së njeriut pakësohet me anë të paralajmërimeve që mbërrijnë tek ai nëpërmjet organeve të jashtme dhe bën që vëmendja shpirtërore të shpërndahet. Për këtë arsye, Allahu e pranon për bashkëbisedues profetin e Tij vetëm pasi ai të ketë kaluar një fazë përgatitore dhe të ketë dëgjuar mirë paralajmërimet që i drejtohen.

– Përse profeti duhet të zbath këpucët?

– Sepse në audiencën hyjno-

re ai nuk duhet të dalë përpara Zotit me këpucët në të cilat mund të jetë ngjitur gjatë rrugës ndonjë copë papastërtie.

– Ose për tu ruajtur nga vesesi që të shtyn pastërtia e lëndës me të cilën qenë përgatitur ato këpucë.

– Komenti më tronditës është edhe ai që pretendon se me zbatohen e këtyre dy këpucëve janë dy botët, kjo botë dhe bota tjetër. Sepse, pa kaluar nga këto dy botë, pa i larguar ato nga shpirti, ai nuk do ta kishte të mundur të takohej me Allahun që nuk ka Zot tjetër përveç Tij dhe nga i Cili do të përzgjidhej si profet dhe nuk do ta kishte të mundur ta perceptonte shpirtërisht shpalljen hyjnore, vahj.

Në pjesën e dytë rreshtohen urdhëresat që janë cilësi të përbashkëta të të gjithë besimeve hyjnore:



Mos të të mashtrojnë ata njerëz që nuk i besojnë kiametit dhe shkojnë pas shijeve dhe qejfeve të tyre, në të kundërt do të jesh i humbur.



a- Besimi në njësinë e Zotit,

b- Adhurimi dhe namazi si përmendje e Zotit,

c- Kiameti dhe ahireti si fenomeni dhe vendi ku do të shpërblehet siç e meriton çdo gjë e kësaj bote

a- Principi i tevhidit përbën bazën e feve hyjnore. Të gjithë fetë dhe profetët që nga Ademi dhe deri tek profeti Muhamed i kanë ftuar njerëzit drejt kësaj të vërtete. Teksa formohej në brumjen e krijimit, njeriu, u gatua nëpërmjet kësaj ndjesie me nevojën për të qenë rob i varur dhe për tu strehuar nën një fuqi madhështore. Për këtë arsye, njerëzit që nuk janë shndërruar në robër të Zotit shkojnë ose pas qejfeve dhe dëfrimeve të tyre epshore, ose pas perëndive të rrejtshme që i kanë krijuar me duart e tyre.

b- Pas besimit në tevhid i vjen radha robërisë ndaj Allahut. Robëria është marrëdhënia më e lartë në mes të njeriut dhe Zotit, sepse Allahu pat marrë një zotim nga shpirtat e njerëzve në këtë kuptim dhe pasi shpirtat i qenë përgjigjur “Po”, pyetjes “A nuk jam Unë Zoti juaj?” që u pat drejtuar Allahu, atëherë u pat nënshkruar ky pakt mes Zotit dhe njeriut. (Araf, 7/172)

Paktet dhe marrëveshjet bëhen që të merren seriozisht dhe që të zbatohen, prandaj moslënia në harresë e tyre është themelore. Allahu e ka emërtuar në formën “dhikr” aftësinë për të mos harruar këtë marrëveshje të kryer me robërit e Tij.

Më pas Allahu e urdhëroi që të falte namazin, sepse në na-

maz ekzistojnë njëkohësisht edhe dhikri dhe përkujtimi, edhe takimi dhe bashkëbisedimi me Allahun. Në sajë të namazit robi a thua se flet shtruar me Zotin e tij dhe duke i paraqitur ndjenjat e tij të robërisë i rrëfen Zotit se lidhja e tij me këtë botë është kalimtare.

c- Në ajetin që vjen më pas, duke i kujtuar ditën e kiametit dhe ditën e llogarisë, theksohet dhe nënvizohet rëndësia e faktit që nuk duhet të mashtrohemi pas kësaj bote kalimtare. Meqë njeriu hapi krahët drejt pafundësisë nga bota e pafillimësisë (ezel) e koncepton praninë e tij në këtë botë në mënyrë të gabuar si diçka të përhershme. Kështu ai kapet fort pas gjërave kalimtare të kësaj jete duke e lënë në hije vendqëndrimin e tij të përjetshëm.

Ndërkohë, veçoria më rëndësishme e besimit të tevhidit dhe të feve hyjnore është dita e kiametit dhe ahireti. Vetëm në pikën e besimit në kiamet dhe në besimin e ahiretit njerëzit përjetojnë probleme të rëndësishme.

Edhe anketat dhe kërkimet e bëra në ditët e sotme japin të njëjtin përfundim. Sipas disave prej tyre nëntëdhjetë për qind e njerëzve të intervistuar shprehen se besojnë në Zot, ndërsa gjysma e tyre tregohen mosbesues ndaj jetës në botën tjetër. Unë besoj se këtu luajnë një rol të rëndësishëm mjetet e informimit dhe era e frymës pozitiviste që serviret ngado. Në të kundërt besimi në Zot dhe në botën tjetër duhet të ishte në vlera të përafërta, sepse besimi në botën tjetër është njëkohësisht edhe një rezultat

logjik i besimit në ekzistencën e Zotit.

Të lënët e njeriut të veprojë ç'të dëshirojë dhe pa përgjegjësi megjithëse ai është krijuar me qëllim marrjen në sprovë dhe lënia e tij larg shqetësimit të llogaridhënies nuk përputhet me logjikën e pastër. Ato që ka hequr njerëzimi gjatë historisë së tij nga njerëzit e fuqishëm dhe mizor që nuk kanë ndjerë aspak shqetësimin e llogaridhënies dhe qenë shndërruar në skllëvër të epsheve të tyre janë të gjitha kujtime që të shtien dridhmën. Shoqëritë në të cilat kanë jetuar njerëz që në thelb kanë ruajtur shqetësimin e llogaridhënies dhe në fund fare edhe shqetësimin për fundin e tyre në botën tjetër kanë realizuar punë të vyera që e kanë ngritur lart vlerën e njerë-

zimit. Ajo që duhet ta udhëzojë njeriun është mendja, ndërsa mendjen duhet ta udhëzojë shpallja hyjnore. Mendja që ia vë veshin shpalljes hyjnore, njeh të vërtetën e njësisë së Zotit, i nënshtrohet robërisë së Zotit dhe e jeton këtë jetë me shqetësimin për fundin e tij në botën tjetër.

Nuk mund të pritet nga njerëzit që e shtypin, e copëtojnë dhe janë egërsuar ndaj njerëzve të tjerë me mendimin "i dalte shpirti atij që gjendet poshtë meje", të realizohet ndonjë gjë që i ka hije vlerave humane. Gjatë historisë vlerat që ne i emërtojmë si qytetërim janë prodhuar vetëm në ato periudha kur njerëzimi është ushqyer nga klima e shpalljes hyjnore, vahj, dhe ka ndjerë thellë në shpirt shqetësimin e besimit

në Zot dhe në botën tjetër.

Njerëzit në përgjithësi i ngatërrojnë me njëra tjetrën lumturinë me prosperitetin dhe mirëqenien. Shpeshherë mendojnë se duke u shtuar shkalla e mirëqenies do të rritet edhe shkalla e lumturisë. Por situata shpesh herë nuk është aspak e këtillë. Edhe kur lehtësohet jeta e mirëqenies, njerëzit mund të mos provojnë shijen e lumturisë. Prandaj si dje, ashtu edhe sot janë të shumtë njerëzit që kanë të mira materiale, por që nuk janë të lumtur. Prandaj lumturinë nuk duhet ta kërkojmë vetëm në prosperitetin material, por në ndriçimin e shpalljes hyjnore duke e dëgjuar me shumë kujdes mesazhin që na kumton shpallja hyjnore.



NGA FORMA DREJT TE VERTETES

*"Veprat nga pamja e jashtme janë të thata,
ajo që i gjallëron ato është enigma e singeritetit."*

Ibn Ataullah el-Iskenderi



Zoti i madh që i krijoi jetën dhe vdekjen në mënyrë që njeriu të dijë të përcaktojë një stil jete sa më të bukur, nuk u jep vlerë veprimeve dhe adhurimeve që kanë vetëm lëvozhgën nga jashtë, madje, na tregon se këto lloj veprash në vend që të na afrojnë më shumë me Të, bëhen shkak që ne të meritojmë dënimin hyjnor. Sa falimentim i madh është fakti që adhurimet, aktet e bindura dhe veprat tona që i kryejmë dhe i përmbushim një jetë të tërë të mos shprehin asnjë vlerë në peshoren hyjnore si kapital i botës tjetër. Miqtë e Zotit, mendjendritur dhe largpamës, duke u nisur nga kjo e vërtetë, kanë qëndruar shumë mbi faktin që përpjekja më e rëndësishme për njeriun është "të

fitojë një zemër dhe shpirt të singertë me anë së të cilave të pastrojë dhe korrigjojë synimet dhe qëllimet e jetës së tij."

Singeriteti (ihlas) do të thotë që në marrëdhëniet tona me Allahun apo gjatë kryerjes së gjithë veprimeve dhe sjelljeve që ne i bëjmë në emër dhe për hir të Tij, të paraqesim një qëndrim të mbushur me besnikëri, zemërciltërsi dhe besueshmëri, duke mos marrë parasysh asnjë shkak personal apo të kësaj jete, duke u kyçur vetëm brenda pëlqimit dhe kënaqësisë hyjnore dhe duke u pastruar nga dyfytërsia.

Vepër e mirë quhet ajo vepër që gëzon këto dy cilësi: 1. Qëllimi me të cilin do të bëhet të jetë i saktë, pra të kihet parasysh

vetëm kënaqësia e Allahut. 2. Të jetë në përputhje me kushtet e jashtme dhe të dukshme që parashikon Kurani dhe Suneti profetik i Muhamedit (a.s.). Në rast se vepra nuk e gëzon njërin nga këto dy kushte veprat tona nuk mund të cilësohen si vepra të mira dhe në fund fare nuk do të pranohen në selinë hyjnore.

Qëllimi ka të bëjë me atë që ndjehet në zemër. Me një fjalë tjetër, zemra është burimi amë ku lind qëllimi. Për sa kohë që burimi nuk është i pastër dhe i kthjellët është fantazi të mendosh se prej saj do të burojnë qëllime dhe synime të pastra. Prandaj edhe ka dalë shprehja: "Pa qenë zemra e pastër, as qëllimi nuk është i pastër, pa qenë

qëllimi i tillë, as vepra nuk është e mirë.” Që zemra të jetë e pastër ajo duhet të pastrohet nga sëmundjet shpirtërore siç janë mohimi i të vërtetës, shirk, dyshimi, zilia, smira dhe dyfytërsia duke u shndërruar në një konsistencë me anë të së cilës mund të realizohet dorëzimi i vërtetë ndaj Zotit. Por të arrihet një nivel i këtillë i konsistencës shpirtërore do të thotë t’i futesh një beteje të rëndësishme dhe të madhe shpirtërore. Në kulturën mistike islame kjo betejë është quajtur edhe “sejru suluk”. Shkaku i lindjes së edukatës mistike është nevoja e metodave për të shpënë njeriun tek sinqeriteti dhe me këtë rast të purifikohet nga bota shpirtërore në atë mënyrë që Zoti të jetë i kënaqur me të.

Këto fjala të thëna nga Rabani, si përkufizim i misticizmit islam, e shprehin shumë qartë këtë të vërtetë:

“Misticizmi (tasavuf), është udhëtimi nga forma e shariatit drejt të vërtetës dhe esencës së shariatit”. Pra, ajo që pret Kurani dhe suneti profetik nga njeriu besimtar është që ai të përpiqet me gjithë ndjesitë e tija fizike dhe ndjenjat e tij shpirtërore që veprat e tija të mos mbesin vetëm në dimensionin e formës dhe të pamjes, por të fitojnë thellësi drejt të vërtetës dhe thelbit të tyre. Besimi i palëkundur në pikat e besimit do

të thotë shpëtim nga shterpësia dhe lartësim në perfeksionim të ekzekutimit të ligjeve islame duke u mbyllur brenda botës së sinqeritetit, ndjenjës dhe meditetit dhe duke u fokusuar me gjithë qenien mbi Zotin dhe të vërtetën.

Këto që thamë nuk e kanë kuptimin se vepra po nuk u përjetua në këtë shkallë shpirtërore është e pavlerë, sepse Zoti ynë, i cili ka rrethuar me mëshirën e Tij të madhe çdo gjë, i vlerëson në një shkallë të caktuar veprat tona që nuk e kanë kapur ende cilësinë e pritjes nga to dhe kështu të paktën bie nga ne barra e madhe që na mundon. Por me këto vepra është e pamundur të afrohemi sa më shumë të jetë e mundur pranë Zotit dhe të jemi aq fatlumë sa të shkrihemi në pëlqimin hyjnor. Për të fituar zemra jonë shkallën e sinqeritetit është domosdoshme që kërkesa dhe dëshira jonë nga Zoti për të arritur këtë shkallë shpirtërore të shndërrohet në refrenin e një lutjeje të gjatë dhe të vazhdueshme pasionante.

Sinqeriteti paraqet ndryshim në varësi të shkallës së adhurimit që kryen njeriu ndaj Zotit. Sinqeriteti i besimtarit të devotshëm distancohet nga çdo lloj dyfytërsie të dukshme dhe të padukshme dhe nuk i shkon pas qejfeve të nefsit. Qëllimi i adhurimeve që kryen njerëzit e

tillë të devotshëm është fitimi i sevapit dhe shpërblimit hyjnor të premtuar dhe mbrojtja nga dënimi hyjnor dhe fundi i keq në botën tjetër.

Adhurimi i besimtarëve pasionantë është për Allahun, ndërsa adhurimi i arifëve (të edukuarve me kulturën shpirtërore) është me Allahun. Të kryesh vepra të mira për Allahun bën që besimtari të fitojë sevape, ndërsa kur punët tona janë bashkë me Allahun, ato bëjnë që njeriu të afrohet sa më shumë me Zotin e tij. Të punuarit për Allahun e çon njeriun drejt të vërtetës së adhurimit, ndërsa të punuarit me Allahun e bën edhe më të shëndoshë vullnetin e tij. Të punosh për Zotin është cilësia e besimtarëve të devotshëm, ndërsa të punosh me Zotin është cilësia e besimtarëve që dëshirojnë vetëm audiencën hyjnore.

Shkalla e sinqeritetit është në përputhje me shkallët e njohjes së vetvetes (nefs) dhe të njohjes së Allahut. Në një hadith profeti Muhamed (a.s.) thotë: “Ji i singertë në jetën tënde fetare.”

Sinqeriteti zotëron një enigmë që e ruan njeriun e singertë, i fal begati atij dhe e takon me të përjetshmen, dhe e gjitha kjo nuk është gjë tjetër përveçse një gosti e Zotit ndaj robërve të Tij të mirë.

Pasojat e braktisjes së urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja



“Besimtarët dhe besimtaret janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, ndalojnë nga e keqja, falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t’i mëshirojë Allahu. Allahu është ngadhënjyes, i urtë”.

Teube: 71



Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja është një institucion shumë i rëndësishëm në jetën e shoqërisë muslimane.

Allahu i madhëruar, në shumë ajete ka treguar pozitën e lartë që ka ky parim në mesin e muslimanëve duke thënë:

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni Alla-

hun...”. (Ali Imran: 110).

Domethënë mirësia e ummetit islam është e lidhur ngushtë me këtë parim dhe këtë rregull, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

Nuk mund të përjetojë mirëqenie një ummet nëse në mesin e tyre nuk ka burra që urdhërojnë në të mirë dhe ndalojnë nga e keqja.

Këtë gjë Allahu i madhëruar, edhe më mirë e sqaron kur tregon se cilësi e shoqërisë mus-

limane është urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, duke thënë:

“Besimtarët dhe besimtarët janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, ndalojnë nga e keqja, falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t’i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjyes, i urtë”. (Et-Teube: 71).

Pra, besimtari është vëlla i

besimtarit, është i dashuri i tij, është miku i tij, është përkrahësi i tij, është i afërmi i tij, edhe këtë afërsi, dashuri, miqësi dhe përkrahje e shfrytëzojnë për të promovuar të mirën dhe për të demaskuar të keqen dhe për ta eliminuar atë tërësisht.

Veti të kundërta kanë hipokritët. Për ta All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Hipokritët dhe hipokritet janë si njëri-tjetri; urdhërojnë për të keqen e ndalojnë nga e mira dhe shtrëngojnë duart e tyre. Harruan All-llahun, prandaj Ai i harroi ata. Nuk ka dyshim, hipokritët janë ata të prishurit”. (Et-Teube: 67).

Nëse ndalemi dhe i analizojmë këto dy ajete, parashtrohet pyetja: shoqëria jonë, a është e ngritur mbi parimet e besimtarëve apo mbi parimin e munafikëve?!

Njerëzit sot, a kanë pjesmarrje aktive në përhapjen e të mirës apo qëndrojnë indiferentë?!

Sa njerëz nga mesi jonë sot mundohen të promovojnë të mirën, urdhërojnë në të mirë, organizojnë aktivitetet ku del në shesh e mira dhe luftohet e keqja, promovohet morali dhe luftohet degjenerimi, stimulohet mësimi dhe edukimi dhe luftohet përtacia dhe dembelizmi?!

Nëse shtohet e keqja në shoqëri dhe mungojnë ata që urdhërojnë në të mirë dhe largojnë nga e keqja, dënimi ka për ti kapur të gjithë ata njerëz.

A nuk mendojmë aspak mbi atë që na ka mësuar populli me urtësi: “krahas barit të tha-



të digjet edhe i njomi”.

Nëse djemtë që nuk falin namaz janë më shumë se ata që falin namaz, domethënë krëndet e thata janë më shumë se ato të njomat.

Nëse djemtë që pijnë alkool janë më shumë se ata që nuk pijnë, domethënë krëndet e thata janë më shumë se ato të njomat.

Nëse djemtë që shkojnë nëpër diskoteka janë më shumë se ata që nuk vijnë në këto vende, domethënë se krëndet e thata janë më shumë se ato të njomat.

Nëse njerëzit që tregtojnë me kamatë janë më shumë se ata që nuk tregtojnë me kamatë, domethënë se krëndet e thata janë më shumë se ato të njomat.

E kur të vijë zjarri do të na kapë të gjithëve, sidomos aty-

re që rrinë indiferentë dhe nuk marrin asnjë iniciativë për të përmirësuar këtë gjendje të mjerueshme që është duke na kapluar.

Lind pyetja: Cili është Ligji i All-llahut për ata që braktisin këtë parim?

All-llahu, subhanehu ve teala, në Librin e tij Fisnik e ka sqaruar shumë bukur se çfarë i pret ata që e braktisin këtë parim dhe e neglizhojnë këtë detyrë.

All-llahu, azze ve xhele, në suren El-Maide, në ajetin 78 dhe 79 thotë:

“Ata që mohuan të vërtetën nga beni israilët, u mallkuan prej gjuhës së Davudit dhe Isait, të birit të Merjemes. Kështu u veprua sepse kundërshtuan dhe e tepruan. Ata ishin që nuk ndalonin njëri-

tjetrin nga e keqja që punonin. E ajo që bënin ishte e shëmtuar". (El-Maide: 78- 79).

Pra, mallkimi i All-llahut qenka ajo që i pret këta njerëz, të cilët e shpërfillin këtë detyrë.

Po pasojat nga braktisja e kësaj detyre cilat janë?

Pasojat janë të shumta, mirëpo ne do të përmendim disa prej tyre:

1- Shtohet e keqeja.

Zejneb bintu Xhahshi, radijall-llahu anha, tregon se një natë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u zgjua i trishtuar nga gjumi.

Zejnebeja tha: o I Dërguar i All-llahut, a do të shkatërrohem edhe pse në mesin tonë ka njerëz të mirë? Tha: Po, nëse shtohet e keqja". (Buhariu dhe Muslimi).



Nëse e keqja publikohet në shoqëri, përhapet me të madhe dhe bëhet normale dhe nëse nuk gjendet kush i del para kësaj të keqe që ta ndalë, atëherë kjo tregon se njerëzit e këqij dominojnë dhe bëhen shkak që njerëzit ti pasojnë ata. All-llahu, tebareke ve teala, u është kërcënuar këtyre njerëzve duke u thënë:

"Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret dënimi i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu i di (të fshehtat) e ju nuk i dini". (En-Nur: 19).

Kështu përhapet e keqja,... Dikush i pari e bën një gabim dhe vepër të keqe, atë e imitojnë të tjerët dhe fillon dalëngadalë të përhapet në atë shtëpi, në atë lagje dhe në atë qytet. Vazhdon përhapja e së keqes dhe normalizimi i saj, saqë bëhet i arsyetueshëm në mesin e njerëzve dhe i pranuar. Kurse në anën tjetër pakësohet e mira dhe bëhet e huaj çdo gjest dhe vepër e devotshme.

Omer ibn Abdulazizi, rahimehull-llah, i shkroi kryetarit të Medinës dhe e urdhëroi atë që t'i urdhëronte dijetarët të mbanin ligjerata nëpër xhami për të përhapur dijen duke u thënë:

"Përhapeni dijen, sepse dija nuk largohet nga njerëzit derisa nuk bëhet sekrete".

Duke u nisur nga kjo thënie shumë e rëndësishme e këtij Imami të madh, hoxhallarët duhet ta kuptojnë edhe më seriozisht detyrën e tyre dhe duhet të organizojnë tubime, mexhlise, tribuna, derse, hut-

be, ligjerata, shkrime, audio-kaseta, e aktivitete të tjera që ta përhapin dijen dhe fenë e All-llahut, subhanehu ve teala.

2- Dënimi dhe shkatërrimi i përgjithshëm.

Këtë e tregoi edhe hadithi i mësipërm.

Kurse All-llahu subhanehu ve teala, na tregoi në Kur'an tregimin e njerëzve të së shtunës. Izraelitëve, All-llahu ua kishte ndaluar punën ditën e shtunë. Një pjesë e izraelitëve ishin afër detit dhe merreshin me peshkim. Kur nuk peshkonin ditën e shtunën, vinin shumë peshq në det, kurse ditëve të tjera kishte më pak peshq. Çfarë bënë ata? Ata e lëshuan rrjetën ditën e xhuma dhe e mblodhën në ditën e dielë. Kur e bënë ata këtë hile, kishte disa njerëz të devotshëm në mesin e tyre dhe i këshilluan që të mos veprojnë kështu. Kurse një grup tjetër që e shikonte këtë mashtrim dhe hile ndaj All-llahut në mënyrë indiferente, u thonin këtyre të parëve: pse po lodheni, ata nuk përfitojnë nga këshilla juaj, andaj ndaluni nga urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqeja. Allahu në Kur'anin Fisnik e përshkruan kështu këtë ngjarje:

"Dhe kur një grup prej tyre thanë: "Përse këshillo-ni një popull që All-llahu do ta shkatërrojë ose dënojë me një dënim të ashpër?" (Këshilluesit) thanë: "Arsyetim para Zotit dhe me shpresë që t'u largohen gabimeve". E kur braktisën atë për të cilën ishin këshilluar, Ne i shpëtuan ata që ndalonin nga të këqijat, ndërsa ata që kundërshtuan i kapëm me një dënim të for-

të, ngase ishin të shfrenuar. E kur ata tejkaluan me arrogancë të hapët nga ajo që ishin të ndaluar, Ne i shndërruam në majmunë të përbuzur”. (El-Araf: 164- 166).

Po, nëse njerëzit e ndalojnë të keqen fitojnë njërën nga dy rezultatet: ose pendohen dhe largohen nga e keqja, ose së paku kanë arsye para All-llahut në Ditën e Kijametit dhe me këtë e mbrojnë popullin e tyre nga shkatërrimi masiv.

Kurse në anën tjetër, nëse njerëzit jepen pas mëkateve, jepen pas alkoolit, drogës, muzikës, kamatës, zinasë, All-llahu u sjell dënime shumë të hatashme, u sjell deformimin e fytyrës dhe natyrës, i shndërron ata njerëz në derra dhe majmuna, sikurse ka ardhur në shumë argumente fetare.

All-llahu, i shpëton ata që ndalojnë nga e keqeja, kurse mëkatarët i dënon, e nëse nuk ka në ummet njerëz që urdhërojnë në të mirë dhe ndalojnë nga e keqja, atëherë askush nuk shpëton.


Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Nëse dikush është në mesin e një populli që bëjnë mëkate dhe ai ka mundësi ta ndryshojë atë e nuk e ndryshon, All-llahu do tu dërgojë dënim para se të vdesin”. (Sahih, Ebu Davudi dhe Ibn Maxheja).

Një ditë doli Ebu Bekri, radijall-llahu anhu, para disa njerëzve e u tha:

O ju njerëz, jeni duke e le-xuar ajetin:

“O ju që besuat, ruajeni veten tuaj! Ai që ka humbur,



“Pasha Atë që në Dorë të Tij është shpirti im, ose do të urdhëroni në të mirë dhe do të ndaloni nga e keqja ose së shpejti All-llahu do t’ju dërgojë dënim prej Tij, pastaj ju do të luteni, mirëpo nuk do t’ju pranohet lutja”.

nuk ju dëmton juve kur jeni në rrugë të drejtë. Kthimi i të gjithë juve është te All-llahu dhe Ai ju njofton për atë që vepruat”. (El-Maide: 105).

Mirëpo jeni duke e keqkuptuar. Kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

“Nëse njerëzit kur e shohin zullumqarin (duke bërë zullum) dhe nuk e ndalin, së shpejti All-llahu ka për ti dënuar të gjithë me një dënim prej Tij”. (Sahih, Tirmidhiu, etj).

Gjithashtu Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Pasha Atë që në Dorë të Tij është shpirti im, ose do të urdhëroni në të mirë dhe do të ndaloni nga e keqja ose së shpejti All-llahu do t’ju dërgojë dënim prej Tij, pastaj ju do të luteni, mirëpo nuk do

t’ju pranohet lutja”. (sahih, Tirmidhiu).

Mëkatet janë shkaku kryesor i katastrofave të ndryshme natyrore.

Para se të vazhdojmë të flasim për pasojat që i sjell mosurdhërimi në të mirë dhe mosndalimi nga e keqja, është mirë të tregojmë, sikurse kemi treguar disa herë në raste të ndryshme, se katastrofat natyrore nuk vijnë vetëm si pasojë e shkaqeve fizike dhe materiale, por edhe si pasojë e mëkateve.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do t’ju hapnim begati nga qielli e toka, por ata përgënjeshtuan, andaj i dënuam me shkatërrim për atë që merituan. A mos u

siguruan banorët e fshatrave nga dënimi ynë kur ata ishin duke fjetur (natën)? A mos u siguruan banorët e fshatrave nga dënimi jonë paradite, kur ata ishin duke luajtur? A mos u siguruan ata prej ndëshkimit të All-llahut? Nuk sigurohet kush prej frikës së ndëshkimit të All-llahut përveç njerëzve të humbur. A nuk e kanë të qartë ata që e trashëguan tokën pas banorëve të saj (që u shkatërruan) se, nëse dëshirojmë Ne i godasim (i dënojmë) për mëkatet e tyre, ua mbyllim zemrat e tyre, dhe ata nuk dëgjojnë (këshillat)”. (El-A’raf: 96- 100).

Gjithashtu All-llahu, tebare-ke ve teal, na tregon se:

“Sikur ata t’i përmbaheshin rrugës së drejtë, Ne do tu lëshonim atyre ujë me bollëk, për t’i sprovuar me të. E kush ia kthen shpinën adhurimit ndaj Zotit të vet, Ai e shpie atë



në vuajtje të padurueshme”. (El-Xhin: 16- 17).

3- Divergjencat dhe grindjet.

Prej pasova më të këqija që sjell në shoqëri mungesa e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqeja është përçarja e shoqërisë, grindja mes tyre, rrahjet mes tyre dhe ofendimet mes tyre.

Kjo gjendje e destabilitetit në një shoqëri vjen si pasojë e mëkateve dhe shkeljes së kufinjve që i ka caktuar All-llahu, subhanehu ve teal.

All-llahu, xhel-le shanuhu, thotë:

“Thuaj: “Ai ka fuqi (t’ju shpëtojë, por edhe) t’ju sjellë dënim nga lart ose nga poshtë nën këmbët tuaja apo t’ju ndajë në grupe e ta luftoni njëri-tjetrin. Shiko se si i sqarojmë faktet në mënyrë që të kuptojnë”. (El-Enam: 65).

Vetëm zbatimi i urdhërave të All-llahut dhe largimi nga ndalesat e Tij e mbron shoqërinë nga grindjet dhe përçarjet, sepse ligji i All-llahut i bashkon dhe afron njerëzit, kurse braktisja e tij e shkakton të kundërtën.

All-llahu subhanehu ve teal, pasi që thirri që të bëhet një grup prej muslimanëve, ose që të bëhen muslimanët që të thërrasin në të mirë, të urdhërojnë në bamirësi dhe të ndalojnë nga e keqeja, na e tërheq vërejtjen që mos të bëhemi nga ata që përçahen dhe grinden duke thënë:

“Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobi-

shme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit. E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u patën zbritur argumentet. Ata do të kenë një dënim të madh”. (Ali Imran: 104- 105).

Përhapja e zinasë e sjell grindjen dhe vrasjen. Sa e sa djem të rinj për shkak të zinasë janë rrahur ose janë vrarë mes tyre?!

Përhapja e alkoolit sjell grindjen dhe vrasjen. Sa e sa djem të rinj janë rrahur dhe grindur mes tyre për shkak se kanë qenë të dehur?!

Tregtia me kamatë sjell grindjen dhe vrasjen. Sa e sa njerëz kanë probleme mes tyre për shkak të marrjes dhe dhënies së parave me kamatë, grindje që zakonisht shpiejnë deri te uzurpimi i pasurisë, rrahja dhe vrasja?!

Bixhozi është shkak që sjell grindjet dhe rrahjet në mesin e njerëzve. Sa e sa njerëz janë rrahur dhe grindur për shkak të lojës së bixhozit?!

Hilja dhe mashtrimi gjatë shitblerjes sjell grindje dhe rrahje. Sa e sa herë mashtrimet dhe hilet në treg kanë qenë shkak për rrahje dhe grindje mes njerëzve?!

Prania e këtyre mëkateve detyrimisht shkaktojnë grindjen mes njerëzve, përçarjen e tyre, prishjen e zemrës së tyre, largimin njëri nga tjetri dhe shthurjen e shoqërisë.

Ndërsa heshtja ndaj këtyre mëkateve dhe gabimeve nënkupton pranimin e tyre.

4- Sundimi nga armiqhtë.

All-llahu, xhel-le shanuhu, mund të sprovojë një shoqëri që ka braktisur urdhërimin në të mirë dhe ndalimin nga e keqeja me dërgim të armikut mbi kokën e tyre. Kjo ka ndodhur në historinë islame edhe është duke ndodhur në kohën e sotshme. Deri dje ishin mbretër, kurse sot qajnë dhe ankohen për padrejtësitë që u bëhen.

5- Nuk pranohet lutja.

Secili musliman që e harron All-llahu në bollëk, i kujtohet Ai kur është në vështirësi. Atëherë i drejtohen Atij me lutje dhe përulje, mirëpo, këto lutje dhe këto duar të ngritura lart, mbeten bosh.


Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem këtë na e ka treguar duke na thënë:

“Pasha Ate që në Dorë të Tij është shpirti im, ose do të urdhëroni në të mirë dhe do të ndaloni nga e keqja ose së shpejti All-llahu do t’ju dërgojë dënim prej Tij, pastaj ju do të luteni, mirëpo nuk do t’ju pranohet lutja”. (sahih, Tirmidhiu).

6- Krizat ekonomike.

Mungesa e këtij parimi në jetën tonë shoqërore sjell varfërinë, sjell krizën ekonomike, sepse bereqeti vjen me devotshmëri dhe punë të mira, kurse punët e liga dhe mëkatet e largojnë shiun, sjellin thatësi-rën, sjellin varfërinë, sjellin sëmundjet dhe vështirësitë. Kurse varfëria sjell edhe kufirin, sikurse ka treguar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur është lutur:

“All-llahu im, më ruaj nga mosbesimi dhe varfëria”. (sahih, Ebu



Davudi).

Varfëria e largon njeriun nga obligimet ndaj All-llahut dhe fesë Islame, e largon njeriun nga farefisi dhe e bën të varur nga të tjerët dhe mosbesimtarrët.

7- Zhytja në mëkate dhe epshe.

Mungesa e këtij parimi shkakton që shoqëria të zhytet në epshe dhe kënaqësi, të cilat i largojnë njerëzit nga veprat e larta dhe madhore, njerëzit lidhen ngushtë me dynjanë, bëhen joseriozë, të ligë dhe të padobishëm.

8- U mundësohet hipokritëve të udhëheqin muslimanët.

Kur mungon urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, jetën e muslimanëve e udhëheqin ata që se kanë aspak

problem dhe nuk brengosen për jetën shpirtërore të tyre, për rregullat dhe obligimet që i kanë ata dhe nuk mundohen aspak tu sigurojnë muslimanëve edhe të drejtat minimale të tyre.

Hapni sytë, mësojeni fenë, zbatojeni në jetën tuaj, publikojeni kudo që gjendeni dhe shtoni veprat e mira, mos nguroni të urdhëroni të mirën dhe të ndaloni nga e keqja me urtësi, butësi, fjalë të ëmbla dhe lutje të singerta që Allahu ta udhëzojë popullin tonë dhe ti japë mirësi në dynja dhe mirësi në ahiret dhe të na mbrojë të gjithë neve nga dënimet e Tij.

Amin...

NAMAZI



“Me të vërtetë namazi të largon nga gjërat e shëmtuara dhe të neveritura.”

Ankebut: 45



Pas besimit në Allahun xh.sh. nuk ka vepër më të madhe se namazi. Namazi është përmendur në Kuran më shumë se 100 herë dhe kjo tregon për rëndësinë që ka ky obligim i madh dhe kjo shtyllë e Islamit. Allahu xh.sh. urdhëron e thotë: **“Me të vërtetë namazi të largon nga gjërat e shëmtuara dhe të neveritura.”** (Ankebut, 45).

Pejgamberi a.s. u ka thënë sahabeve: *“A mendoni se, sikur një lum të kalojë para derës së*

ndonjërit prej jush, e ai të lahet në të pesë herë në ditë, a do të mbetet në të ndonjë papastërti? I thanë: Jo. Tha: Kështu është ai që fal pesë kohët e namazit, Allahu me to ia fshin atij gabimet.” (Buhariu)

Namazi është shpëtim. Allahu xh.sh. në suren Muminun urdhëron e thotë: *“Kanë shpëtuar besimtarët, ata të cilët janë të përlurur dhe të kujdesshëm në namazin e tyre”*. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Gjëja e parë që do të japë llogari njeriu Ditën e kiametit, është namazi dhe nëse e*

ka në rregull atë, të gjitha punët e tjera do t'i ketë në rregull, por nëse s'e ka në rregull atë, edhe punët e tjera nuk do t'i ketë në rregull...” (Tirmidhiu)

Namazi është shtylla e fesë, drita e besimit dhe zemrës, çelësi i lumturisë dhe miraxhi i besimtarit. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Dallimi ndërmyet njeriut besimtar dhe jobesimtar është namazi”* (Muslim) Porosia e fundit e Pejgamberit a.s. para se të ndërronte jetë ka qenë namazi. *“Nama-*

zin, namazin!" (Ibn Maxhe)

"Namazi ia mundëson njeriut që të jetë më afër Allahut xh.sh". Namazi është shërues i shpirtërave të trazuar. Namazi është ushqim i shpirtit, "Namazi është drita e syve!"

Pejgamberi a.s. kur kishte ndonjë problem i thoshte Bilalit r.a. myezinit të tij. "Thirre ezanin na i qetëso zemrat me namaz o Bilal".

Ibn Kajimi ka thënë: "Në zemrën e njeriut gjendet një lëmsh, të cilin nuk e zgjidh veçse afrimi me Zotin. Në zemrën e njeriut ka vetmi, të cilën nuk e largon veçse miqësia me Zotin. Në zemrën e njeriut ka frikë dhe shqetësim, të cilën nuk e largon veçse duke iu drejtuar Zotit. Në zemrën e njeriut ka keqardhje, të cilën nuk e largon veçse të jesh i kënaqur me Allahun. Nëse njerëzit kënaqen me këtë botë, kënaqu ti me Zotin. Nëse gëzohen njerëzit me dynjanë, gëzohu ti me Zotin. Nëse njerëzit ndihen të qetë me të afërmit e tyre, ndihu i qetë ti me Zotin. Nëse njerëzit shkojnë te paria e vendit duke u nënshtuar ndaj tyre për t'u kërkuar të mira materiale, nënshtrohu ti ndaj Zotit.

Transmeton Ebu Hurejre r.a. dhe thotë: "Erdhi një njeri tek Pejgamberi a.s. e i tha: O i Dërguari i Allahut më trego një punë që nëse e bëj më çon në xhenet, Pejgamberi a.s. i tha: "Të adhurosh Allahun xh.sh dhe të mos i shoqërosh asgjë Atij, të falësh namazin, të japësh zekatin, dhe të agjërosh Ramazanin". Njeriu tha: Pasha Atë në dorë të cilit është shpirti im, nuk do të shtoj gjë mbi këto që më the. Pasi iku Pejgamberi a.s. tha:



**"O ju që besuat,
kur të bëhet
thirrja për namaz,
ditën e xhumasë,
nxitoni për ta
përmendur Allahun
e lini shitblerjen, kjo
është shumë më
e dobishme për ju
nëse jeni që e dini."**

"Kush dëshiron që të shikojë njeri prej xheneti, le ta shikoj këtë njeri". (Buhari, Muslim)

E kanë pyetur Pejgamberin a.s. Cila është vepra më e mirë? Ai ka thënë: "Falja e namazit në kohën e vet." (Buhari, Muslim)


Gjëja e parë për të cilën do të ankohen banorët e zjarrit në Ditën e gjykimit dhe për të cilën do të qortohen do të jetë namazi. Allahu xh.sh. thotë: "Çfarë ju ka sjellë në Sakar?" Ata do të përgjigjen: "Nuk ishim nga ata që falnin namaz". (Mudethir, 42, 43)

Allahu xh.sh thotë: "Urdhëroje familjen tënde, që të falë namaz, edhe ti vetë zbatoje atë..." (Ta Ha, 132). Familja është shkolla e parë në të cilën të rinjtë marrin bazat e të menduarit dhe edukatës për fenë dhe jetën e tyre të ardhme.

Shumica e njerëzve janë dhënë pas kënaqësisë së kësaj bote dhe e kanë harruar botën tjetër, botën në të cilën kemi për t'u kthyer të gjithë pa dyshim.

Allahu xh.sh na ka obliguar që kur të vij koha e namazit ta lëmë punën dhe ta falim namazin. Allahu xh.sh thotë: "O ju që besuat, kur të bëhet thirrja për namaz, ditën e xhumasë, nxitoni për ta përmendur Allahun e lini shitblerjen, kjo është shumë më e dobishme për ju nëse jeni që e dini." (Xhuma, 9)

Armiktë e Islamit dhe të kombit shqiptar kanë synuar gjithmonë dhe synojnë përçarjen dhe shkatërrimin e familjes, për të eliminuar fuqinë dhe rolin e saj aq pozitiv po ashtu edhe edukativ. Dhe dita-ditës mundohen që t'ia arrijnë qëllimeve të tyre në mënyra nga më të ndryshmet dhe kryesisht



me mjetet e informacionit siç janë radio, televizioni, gazetat, revistat, etj.

Namazi është një lidhjet mes robit dhe Zotit xh.sh. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush e fal namazin, ai komunikon me Allahun xh.sh..” (Buhariu)

Pejgamberi a.s. thotë se Allahu xh.sh. ka thënë: “E kam ndarë namazin në dy pjesë, gjysma më takon Mua dhe gjysma i takon robit tim, dhe robit Tim do t’i jap atë që kërkon. Kur rob thotë: “Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve. Allahu xh.sh. thotë më falënderoi rob Im”. Kur rob thotë: “Mëshiruesi, Mëshirëbërësi” Allahu xh.sh. thotë: “Më lavdëroi rob Im” Kur rob thotë: “Sunduesi në ditën e gjykimit”, Allahu xh.sh. thotë: “Më lartësoi rob Im”. Kur rob thotë: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”. Allahu xh.sh. thotë: “Kjo është

mes Meje dhe robit Tim, dhe robit Tim do t’i jap atë që kërkon”. Kur rob thotë: “Udhëzoni në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur”. Allahu xh.sh. thotë: “Kjo është e robit Tim dhe do t’ia jap atë që më kërkoj”. (Ahmedi, Muslimi)

Filozofi francez, jomysliman, i quajtur Renan, për namazin ka thënë: “Nuk ka asnjë xhami, në të cilën kam hyrë, e të mos më zgjohet një dashuri e zjarrtë, apo të mos ndjej një keqardhje të madhe, përse unë nuk jam mysliiman”.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Melekët luten për atë që falë namazin për sa kohë ai të qëndrojë në vendin ku është falur, duke thënë: O Allah mëshiroje atë, O Allah falja gjynahet atij, O Allah pranoja pendimin, dhe kështu luten derisa të ngrihet apo të flas.” (Buhariu, Muslim)

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi a.s. është i dërguari i Tij. Falja e namazit, Dhënia e zekatit, Haxhi për atë që ka mundësi, dhe agjërimi i muajit të Ramazanit.” (Buhari, Muslim).

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Pesë namazet e ditës dhe xhumanja deri në xhumanë tjetër ia fshijnë njeriut gjynahet ndërmjet tyre nëse nuk bën gjynahe të mëdha.” (Tirmidhiu)

Kanë të drejtë ta lënë namazin dhe të mos falen vetëm 3 grupe të njerëzve:

1. Qafirrit nuk i kërkohet namazi.

2. Fëmija para moshës shtatë vjeçare. Kur të arrijë në moshën shtatë vjeçare duhet ta mësojmë që të falet.

3. I çmenduri nuk e ka farz namazin.

Nuk duhet që namazin ta falim me shpejtësi. Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejra r.a. i cili thotë: “Hyri një njeri në xhami, e Pejgamberi a.s. ishte ulur aty. Ky njeri u fal dhe erdhi e përshëndeti Pejgamberin a.s. Ai ia ktheu selamin dhe i tha: “Kthehu e falu, se ti nuk u fale”. Shkoi u falë dhe u kthye përsëri, e Pejgamberi a.s. përsëri i tha: “Kthehu e falu, se ti nuk u fale”. E kur erdhi për të tretën here, pasi që Pejgamberi a.s. e urdhëroi që prapë ta përsërisë namazin, njeriu tha: “Pasha Atë i Cili të dërgoi me të vërtetën, nuk di më mirë se kjo, më mëso!”. “Pejgamberi a.s. i tha: Kur të fillosh namazin, thuaj ‘Allahu ekber’, pastaj lexo ç’të duash prej Kuranit, e kur të biesh në ruku, qetësohu mirë, pastaj ngrihu derisa të drejtohet kurriizi! Kur të biesh në sexhde, qetësohu mirë në atë pozitë, pastaj ulu mes dy sexhdeve dhe qetësohu mirë e kur të biesh prapë në sexhde qetësohu mirë edhe në atë pozitë! Kështu le të jetë i tërë namazi yt!”.

Këtë shkrim po e përfundojmë me një lutje që ka bërë Ibrahim a.s. “O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet!” (Ibrahim, 40).

10 sëmundjet që shëron agjërimi

Shkenca e sotme ka zbuluar se agjërimi forcon sistemin imunitar tek agjëruesi, për t'i bërë ballë shumë sëmundjeve. Agjërimi është një adhurim i veçantë tek Allahu i Lartësuar. Ai është një prej detyrimeve me të cilat nuk u dallua vetëm umeti mysliman, por edhe bashkësitë e tjera fetare para nesh. Kjo tregon rëndësinë e tij. Më poshtë do të njihemi me rolin e agjëritimit në shërimin e shumë sëmundjeve, të vërtetuara në sajë të eksperimenteve reale.

1. OPERACIONI

Agjërimi kryen funksionin e kirurgut duke eliminuar prej trupit qelizat e shkatërruara dhe të dobëta. Uria që shoqëron agjërimin vë në lëvizje aparatet e brendshme të trupit duke konsumuar qelizat e dobëta për të përballur këtë uri, kështu që trupit i jepet rasti i volitshëm të rikthejë gjallërinë dhe aktivitetin e tij. Gjithashtu, agjërimi është mbrojtje për trupin prej shumë tepricave të dëmshme si për shembull: gurët, shtresat e mishit, gjëndrat dhjamore, madje edhe vetë plagët në fillimin e formimit të tyre.

2. SËMUNDJET E LËKURËS

Agjërimi është i dobishëm në kurimin e sëmundjeve të lëkurës pasi ai pakëson përqindjen e ujit në gjak. Pakësimi i tij në lëkurë sjell forcimin e imunitetit të lëkurës dhe rezistencë ndaj mikrobeve dhe sëmundjeve epidemike, pakësimin e sëmundjeve të lëkurës, të cilat përhapen në sipërfaqe të mëdha të trupit, pakësimin e sëmundjeve alergjike duke i vënë kufi problemeve të lëkurës së yndyrtë. Me agjërimin pakësohen sekrecionet helmuese të zorrëve dhe zvogëlohet për-

qindja e thartimit që shkakton puçrra të vazhdueshme.

3. DHIMBJET E KYÇEVE

Kjo është një sëmundje shumë e përhapur, sidomos në moshat 30-50 vjeç. Problemi i vërtetë është se mjekësia e sotme ende nuk ka arritur në ndonjë mjekim për këtë sëmundje. Eksperimentet praktike në Rusi kanë vërtetuar se agjërimi gjate tri javëve të njëpasnjëshme, ndihmon trupin që të shkarkojë mbeturinat dhe lëndët helmuese, shkaktare të kësaj sëmundjeje. Këto ekspe-



rimente janë bërë mbi një grup të sëmurësh dhe rezultatet kanë qenë të kënaqshme.

4. TROMBOZA

Agjërimi ka ndikim të madh në mbrojtjen prej trombozës së zemrës dhe trurit. Shumë studiues shkencore e mjekësore kanë vërtetuar se agjërimi zvogëlon përqindjen e yndyrave në trup, duke zvogëluar kështu kolesterolin. Kjo lëndë ngjitet në muret e damarëve duke sjellë rritjen e përqindjes së tij dhe rritjen e yndyrave në trup, si rrjedhim çon në ngrirjen e damarëve duke shkaktuar edhe hollimin e damarëve të zemrës dhe të trurit.

5. DIABETI

Agjërimi është një rast i mire për të zvogëluar përqindjen e sheqerit në gjak në pikën më të ulët të tij. Ai i jep gjëndrave të pankreasit një rast të mire për

pushim, sepse detyra e tij është të prodhojë insulinë, e cila e shndërron sheqerin në yndyra që depozitohen në inde. Kur ushqimi e kalon masën e insulinës së sekretuar, pankreasi lodhet dhe, si rrjedhojë, e ndërpret aktivitetin e tij, kështu sheqeri grumbullohet në gjak duke rritur përqindjen e tij gradualisht, derisa shfaqen simptomat e sëmundjes. Për këtë arsye, klinikat e ndryshme kuruese, në tërë botën, praktikuan agjërimit si metodë kurimi për të sëmurët me diabet, në periudha të ndryshme kohe, në varësi të gjendjes shëndetësore të tyre. Kjo metodë ka pasur rezultate dhe sukses të kënaqshëm pa përdorur ilaçe të tjera.

6. PËRDHESI

Sëmundja e mbretërve, ndryshe quhet edhe "përdhesi", krijohet nga ngrënia e tepërt, sidomos e mishit. Shkaku është defekti që ndodh në grumbullimin e proteinave të gjendura në mishra, sidomos në mishin e kuq, gjë që çon në grumbullimin e acidit të urinës, sidomos në nyjën e gishtit të madh të këmbës. Gjatë prekjes së nyjës me këtë sëmundje ajo enjtet dhe skuqet duke u shoqëruar me dhimbje të mëdha. Ndosh-ta masa e kripërave në urinë mund të rritet e pastaj të grumbullohet në veshka duke formuar gurë. Pakësimi i masës së ushqimit është kurimi kryesor i kësaj sëmundjeje shumë të përhapur.

7. INFEXSIONET

Dobia e agjërimit shfaqet në mënyrë të hapur tek të sëmurët me infeksionet periodike të tretjes e në krye të tyre janë:

infeksioni periodik i stomakut, vështirësia e tretjes dhe trazimi i zorrëve. Agjërimi i jep këtyre organeve mundësinë e pushimit për më se një muaj. Gjithashtu, ai ka ndikim të madh edhe në kurimin e tyre, madje edhe të sëmurët me kolonë përfitojnë shumë prej agjërimit. Tek të sëmurët me alergji, agjërimi dhe racionalizimi i ushqimit ndihmojnë të largohen shumë sëmundje alergjike. Pushimi i aparatit tretës është i domosdoshëm për të shëruar shpejt disa sëmundje.

8. SËMUNDJET E ZEMRËS

Agjërimi ka një vlerë të madhe për shumë sëmundje të zemrës, pasi 10 për qind e gjakut të pompuar nga zemra shkon në aparatit tretës gjatë procesit të tretjes. Kjo sasi zvogëlohet gjatë agjërimit, sepse nuk kemi proces tretjeje gjatë ditës. Kjo do të thotë më pak lodhje dhe më shumë qetësi për muskujt e zemrës.

9. DHJAMOSJA

Agjërimi, pa e tepruar, është mjeku më i afte dhe më i lirë. Ai çon në uljen e peshës, me kusht që ta shoqërojnë normaliteti në sasinë e ushqimit në kohën e iftarit dhe njeriu të mos e fryjë stomakun me ushqim e lëngje pas agjërimit. Vetë profeti Muhamed (a.s) e fillonte iftarin me disa kokrra hurma ose me pak ujë e pastaj ngrihej dhe falte namazin e akshamit. Kjo është tradita dhe metoda më e mirë për atë që agjëron, që ndërpritet nga ushqimi e lëngjet për orë të tëra. Sheqeri i gjendur në hurma i sjell njeriut ndjesi ngopjeje, pasi gjaku e thith shumë shpejt e në të njëjtën kohë i jep trupit energjinë e nevojshme për të vazhduar ak-



tivitetin e mëtejshëm. Por nëse e fillon ngrënien pas një urie të gjate duke ngrënë mish e bukë, atëherë tërë këto ushqime duan një kohe të gjate të treten e një pjesë e tyre të shndërrohet në sheqer që si rrjedhim njeriu të ndihet i ngopur. Kështu njeriu vazhdon të mbush stomakun e tij mbi masë, duke menduar se ai akoma është i uritur.

10. Box: KURIM PSIKOLOGJIK

Agjërimi nuk shëron vetëm sëmundjet e trupit, por ai është edhe një kurim i mirë psikologjik. Më poshtë po paraqesim mendimin e një personi që ka provuar të agjërojë pa pasur asnjë lidhje me islamin. Tom Bernez, student në shkollën "Kolumbia", dega gazetari, thotë: "Unë e konsideroj agjërimin më shumë si eksperiencë të thellë shpirtërore, sesa trupore. Megjithatë fillova të agjëroj për të ulur peshën e tepërt, e kuptova që ai është shumë i dobishëm edhe për aktivitetin e trurit. Agjërimi ndihmon si në mënyrën e të menduarit, në lindjen e ideve të reja, ashtu edhe në përqendrimin e ndjenjave. Nuk kishin kaluar shume ditë nga fillimi i agjëritimit në strehimin shëndetësor "Bulling", kur ndjeva që po kaloja një gjendje lartësimi shpirtëror të paimagjinueshëm. Tani e bëj një gjë të tillë disa herë e në periudha kohore nga një deri në gjashtë dite. Në fillim qëllimi ishte të pastroja trupin nga shëndeti i tepërt, por tani agjëroj për të pastruar edhe shpirtin tim nga tërë të metat që kane ngecur në të gjatë jetës sime, sidomos pasi shëtita nëpër bote për disa muaj dhe pashe padrejtësitë në të cilën jetojnë shumë njerëz. Ndiej se jam përgjegjës në një mënyrë apo tjetër për atë që u ndodh



"Kush e lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, atij për këtë i takon një e mirë, ndërsa kjo e mira është me dhjetëfishin e saj."

atyre, kështu që agjëroj si falje për këtë. Kur agjëroj më ikën tërë dëshira për ushqim e tërë trupi ndien një rehati të madhe. Ndiej që shpirti im largohet nga ndjenjat e këqija si: lakmia, xhelozia, dëshira për sundim. Gjithashtu, ndiej të largohen edhe disa gjëra që më ndjekin pas si: frika, luhatja, ndjenja e mërzisë. Tërë këto nuk i ndiej të ndikojnë tek unë gjatë agjëritimit dhe gjej një mirëkuptim të mrekullueshëm me tërë njerëzit gjatë tij".

Studim mbi vlerat kuruese të agjëritimit

Në një studim të paraqitur në konferencën e sëmundjeve të zemrës në Arabinë Saudite në shkurt të 1998, janë eksperimentuar mbi 86 të sëmurë me sëmundje të ndryshme të zemrës si, damarët apo valvulet e zemrës. 86 për qind e tyre arritën të agjëronin tërë muajin

e Ramazanit dhe vetëm 10 për qind e tyre u detyruan ta ndërprisnin atë disa ditë dhe në përfundimin e muajit, 78 për qind e tyre ndjenë përmirësim të gjendjes shëndetësore, kurse 11 për qind e tyre ndjenë të shtoheshin simptomat nga të cilat ankoheshin. Agjërimi ndihmon në kurimin e tensionit të lartë të gjakut, sepse ulja e peshës që shoqëron agjërimin, ul gjithashtu edhe tensionin e gjakut në mënyrë të dukshme, si edhe lëvizjet fizike në namazin e teravisë ndihmojnë në uljen e tensionit të gjakut. D. Shahid Ethar në një hulumtim të botuar në revistën amerikane "Jirir" përcakton se personi gjatë namazit të teravisë konsumon 200 kalori. Kështu, nëse agjëruesi i përmbahet një ushqimi normal, duke evituar teprimin në yndyra dhe sheqerna, do të gjejë tek Ramazani mbrojtje për zemrën e tij dhe kurim për sëmundjen e saj.

Rregulla mbi agjërimin



*“... Ne nuk dënojmë asnjë popull, para se të
çojmë të dërguar!”*

(El-Isra' 17:15).



Agjërimi i muajit të Ramazanit fillon kur shihet hëna e re, kjo ndodh natën e 30-të të muajit Shaban. Nëse në këtë natë nuk shihet hëna e re, atëherë agjërimi fillohet pasi muaji Shaban të ketë mbushur 30 ditë, sepse muaji hënor nuk është më shumë se 30 ditë. Hëna e re shihet pas perëndimit të diellit në fund të ditës së 29 të muajit Shaban, nëse ajo duket para perëndimit, atëherë ajo nuk merret parasysh.

Nuk lejohet agjërimi i ditës së dyshimte, që është dita e 30 e muajit Shaban. Nëse nuk e shohim hënën për shkak të reve, duhet të plotësojmë 30 ditët e muajit Shaban.

Agjërimi është ndalimi i vetvetes nga ushqimi, pirja dhe marrëdhëniet intime nga fillimi i lindjes së diellit deri në perëndim, me qëllim adhurimin e Allahut të Lartësuar.

Agjërimi është detyrim për çdo musliman, i cili ka arri-

tur moshën e pjekurisë, është i shëndetshëm mendërisht, nuk është udhëtar dhe është i afte për të agjëruar, sepse është i liruar nga gjërat që e ndalojnë agjërimin.

Fëmija nëse arrin moshën e pjekurisë në një nga ditët e Ramazanit detyrohet të agjërojë pjesën e mbetur të ditës dhe nuk detyrohet ta kompensoj atë. Është mirë që fëmija të mësohet me agjërim para se të arrijë moshën e pjekurisë.

Nëse të sëmurit agjërimi nuk i bën mirë, atij nuk i lejohej të agjërojë. Nëse agjërimi për të është i vështirë, atëherë preferohet prishja e agjërit. Nëse për të agjërimi nuk është i vështirë, atëherë ai obligohet të agjërojë.

Nëse i sëmuri shërohet gjatë ditës dhe i largohet arsyeja e prishjes së agjërit, atij i lejohet ta vazhdojë ditën pa agjëruar.

I sëmuri i cili nuk mundet të agjërojë dhe nuk shpresohet në shërimin e tij, obligohet të mos agjërojë, dhe për çdo ditë (të ramazanit) të ushqejë një të varfër si kompensim. Ai e bën këtë vetëm pasi të përfundojë dita. Të njëjtën dispozitë kanë dhe ata që janë të paaftë për agjërim dhe nuk pritet se do të aftësohen ndonjëherë, si pleqëria e thellë.

Ai që nuk është i shëndetshëm mendërisht, nuk obligohet të agjërojë dhe as të kompensojë agjërimin, sepse është i liruar nga të gjitha dispozitat.

Udhëtarit i lejohet prishja e agjërit për shkak të udhëtimit nëse nuk has në vështirësi.

Nëse për të është njësoj e lehtë si të agjërojë apo jo, atëherë preferohet që ai të agjërojë, pasi kështu lirohet nga detyrimi i agjërit dhe është më e lehtë për të të agjërojë me njerëzit. Ky është edhe mendimi i shumicës së dijetareve.



Agjërimi është ndalimi i vetvetes nga ushqimi, pirja dhe marrëdhëniet intime nga fillimi i lindjes së diellit deri në perëndim, me qellim adhurimin e Allahut të Lartësuar.

Nëse udhëtari përfundon udhëtimin duke arritur në shtëpi, atij i lejohet të vazhdojë ditën pa agjëruar, sipas mendimit më të sakte, kurse nëse arrin në shtëpi si agjëruar nuk i lejohet ta prishë atë.

Nëse njeriu del nga shtëpia si udhëtar duke agjëruar, atij i lejohet ta prishe atë kur të largohet nga vendbanimet që gjenden në qytetin apo fshatin e tij.

Nëse ndodh që agjëruesi të arrijë mëngjesin duke qenë xhunub, nga marrëdhëniet intime apo diçka tjetër, ai duhet të vazhdojë agjërimin, edhe pse nuk është i pastruar deri pas lindjes së diellit. Gjithashtu edhe gruaja që është me menstruacione, nëse i ndalen ato natën, por ajo nuk është

pastruar derisa del mëngjesi, ajo e agjëron atë ditë.

Kush e humb vetëdijen gjatë ditëve të ramazanit, ai i plotëson ato pasi ti kthehet vetëdija.

Atij që i kanë mbetur pa agjëruar ditë nga Ramazani dhe e vonon këtë, afati i fundit për kompensimin e tyre është fillimi i muajit Ramazan të vitit tjetër. Nëse ai nuk ka arsye.

Kush e vonon pa arsye agjërimin kaza të atyre ditëve që nuk i ka agjëruar, derisa të vijë Ramazani i ardhshëm, nga ai kërkohet të pendohet dhe të plotësojë këto ditë.

GJËRAT QË E PRISHIN AGJËRIMIN.

Marrëdhëniet seksuale. Nëse ndodhin gjatë ditëve të rama-

zanit, në kohën kur je agjërues: Ajo ditë konsiderohet e prishur dhe obligohet vazhdimi i pjesës tjetër të ditës me agjërime dhe kaza për atë ditë. Meqë kjo vepër e bërë me dashje, është mëkat, atëherë kërkohet nga personi të bëjë tevbe (pendim). Si shlyerje për mëkatën e bërë ai detyrohet të agjërojë dy muaj rresht pa ndërprerje, dhe nëse nuk ka mundësi për këtë ai detyrohet të ushqejë 60 te varfër e nëse as për këtë nuk është i aftë atëherë obligimi bie.

Ejakulimi (dalja e spermës) me dëshirën, qofte kjo me puthje, prekje, shikim apo masturbim e prish agjërimin. Nëse kjo gjë ndodh në gjumë atëherë agjërimi nuk prishet, pasi kjo gjë ka ndodhur pa dëshirë.

Ngrënia dhe pirja dhe çdo



gjë që nënkuptohet me këtë, si infuzionet ushqyese. Injekcionet joushqyese nuk e prishin agjërimin.

Marrja e gjakut apo dializa e prishin agjërimin.

Vjellja e ushqimit me dëshirë e prish agjërimin. Nëse një gjë e tillë ndodh pa dëshirë, atëherë agjërimi nuk prishet.

Rrjedhja e gjakut të hajzit apo nifasit. Kurdo që femra shikon gjakun e hajzit apo të nifasit duhet ta ndërpresë agjërimin, pasi ai konsiderohet i prishur.

Nuk i lejohet agjëruesit të përpijë ushqimet që i kanë ngelur nëpër dhëmbë, nëse kjo gjë ndodh pa dije, atëherë agjërimi i tij nuk prishet.

Nëse rrjedh gjak nga dhëmbët apo goja, nuk i lejohet agjëruesit ta përcjellë atë pasi ajo konsiderohet e papastër dhe me të prishet agjërimi.

AGJËRIMI NUK PRISHET NGA

Përdorimi i kuhlrit (një ngjyruer për sytë) apo ilaçit (me pika) për sytë nuk e prish agjërimin, edhe nëse e ndiejmë atë në fyt.

Agjërimi nuk prishet nëse përdor pika në vesh, apo vendos ilaç mbi plagë, edhe nëse e ndien shijen e ilaçit në fyt.

Agjërimi nuk prishet nëse përdor ilaçe nga anusi apo organi gjenital, qofte kjo për temperaturë apo tjetër.

Nëse agjëruesi provon gjellën, pa e gëlltitur atë, apo i merr erë parfumit nuk e prish agjë-

rimin.

Nëse agjëruesi përdor misvakun (një lloj bime që përdoret për pastrimin e dhëmbëve) nuk e prish agjërimin, madje përdorimi i tij gjatë gjithë ditës është sunet.

Agjëruesit i lejohet të bëjë çdo gjë që i lehtëson atij agjërimin, si psh mosdalja në diell dhe larja me ujë të ftohtë.

AGJËRIMI DHE FEMRA

Gruaja që është me menstruacione (hajz) apo lehonë (nifas) nuk lejohet të agjërojë, ndërkohë që për të kërkohet t'i kompensoj me agjërim ditët që nuk i ka agjëruar (agjërim kaza). Nëse fillon të ketë gjakrrjedhje gjatë ditës së Ramazanit, agjërimi i saj prishet. Nëse gruaja pastrohet nga menstruacionet apo lehonja gjatë ditës së Ramazanit, nuk obligohet të agjërojë pjesën tjetër të ditës.

Gruaja shtatzënë apo ajo që e ka fëmijën në gj, nëse frikësohet për fëmijën e saj apo për veten, i lejohet prishja e agjëritit dhe i kërkohet të agjërojë më vonë (kaza). Sipas mendimit më të saktë të dijetareve, në këtë rast ajo nuk obligohet të ushqejë për çdo ditë një të varfër.

Dijetarët kanë rënë dakord që, nëse menstruacionet ndërpriten menjëherë pas agimit, domethënë pas hyrjes së kohës së namazit të sabahut, gruaja duhet të agjërojë një ditë tjetër për të zëvendësuar agjërimin e asaj dite.

Agjërimi i asaj gruaje, së cilës i rrjedhin sasi të vogla pikash gjaku, gjatë gjithë muajit të Ramazanit është i saktë, pasi këto pika gjaku nuk janë prej gjakut të menstruacioneve, por dalin prej enëve të gjakut. Sipas disa transmetimeve të sakta, kur Ali bin Ebu Talib u pyet për këtë, tha se rrjedhja e gjakut në këtë mënyrë, është e ngjashme me rrjedhjen e gjakut nga hundët, domethënë se ky gjak nuk është prej menstruacioneve.

Agjërimi i gruas nëse menstruacionet apo lehonja ndërpriten para agimit, domethënë para se të hyjë koha e namazit të sabahut, por ajo ka mundësi të lahet vetëm pas agimit, në të dyja rastet është i saktë, sepse rasti i saj është i ngjashëm me rastin e xhunubit, të cilin mund ta zërë ezani i sabahut pa u larë akoma. Allahu i Madhëruar thotë: “Tani mund të kryeni marrëdhënie seksuale me gratë tuaja (gjatë netëve të Ramazanit) dhe kërkonin atë që ka caktuar Allahu për ju. Hani e pini deri sa të dallohet peri i bardhë (drita e agimit) nga ai i ziu (errësira e natës) në agim.” (Bekare, 187)

Pra, përderisa marrëdhëniet seksuale janë të lejuara deri në agim, sigurisht që larja nuk mund të bëhet vetëm pas agimit, domethënë pasi të hyjë koha e namazit të sabahut. Po ashtu, Aishja thotë: “Pejgamberi, paqja qoftë mbi të, gdhiehej xhunub dhe agjëronte.” Pra, Pejgamberi, paqja qoftë mbi të, lahej pas



hyrjes së kohës së namazit të sabahut.

Nëse rrjedhja e gjakut të menstruacioneve fillon pas perëndimit të diellit, atëherë agjërimi i saj është i saktë, pavarësisht nëse shenjat e ardhjes së menstruacioneve apo dhembjet e zakonshme të tyre fillojnë para perëndimit.

Agjërimi i gruas që sheh se është duke i rrjedhur pak gjak, por nuk është e sigurt nëse është gjak menstruacionesh apo jo është i saktë, sepse ajo konsiderohet e pastër derisa të sigurohet plotësisht se gjaku i dalë është i menstruacioneve.

Sekrecioni i bardhë nuk shfaqet te të gjitha gratë, prandaj ato gra që nuk e kanë zakon të shohin sekrecionin e bardhë, duhet të agjërojnë.

Ndërsa ato gra, te të cilat dalja e sekrecionit të bardhë është e zakonshme, nuk duhet të agjërojnë derisa ta shohin atë.

Gratë të cilat i zë Ramazani pa plotësuar akoma agjërimin e ditëve të lëna nga Ramazani i kaluar, duhet të pendohen sinqerisht për këtë vepër dhe të kërkojnë falje nga Allahu, sepse vonimi pa arsye i zëvendësimit të ditëve të lëna, deri në ardhjen e Ramazanit tjetër, është kategorikisht i ndaluar. Aishja, e shoqja e Pejgamberit, thotë: “Në disa raste nuk kam pasur mundësi që t’i agjëroja ditët e lëna nga Ramazani, përveç se në Shaban.” Sidoqoftë, ato duhet t’i zëvendësojnë ditët e lëna nga Ramazani i parë, pas mbarimit të Ramazanit të dytë.



Merita e muajit të Ramazanit

Prej sezonave më madhështore të mirësisë është ky muaj fisnik, muaji i Ramazanit të bekuar, të cilin Allahu xh.sh. e ka graduar me zbritjen e Kur'anit në të, librin më madhështor, fjalën e Allahut xh.sh., të cilës nuk mund t'i mvishet e pavërteta as nga para e as nga prapa. Ai është kushtetutë e përjetshme për udhëzimin e njerëzimit, ligj i qiellit për udhëzim në tokë:

“Muaji i Ramazanit që në të (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra)”¹.

Allahu xh.sh. ia ka dhuruar këtij ymmeti këtë muaj për çdo vit. Ka njerëz të cilët e presin atë me përzemërsi e me nderim, ndërsa ekzistojnë edhe të atillë prej të cilëve del Ramazani duke bartur me vete kuj-

timet dhe mbresat më të këqija për ta.

Qoftë i bekuar ai për të cilin Ramazani do të ndërmjetësojë për të (do të bëjë shefat), dhe lum për atë që Kur'ani do të bëjë shefat për të. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Agjërimi dhe Kur'ani do të kërkojnë mëshirë (shefat) për besimtarët në Ditën e Gjykimit, do të thotë agjërimi: O Zoti im e kam ndaluar nga ushqimet dhe nga marrëdhëniet intime gjatë ditës, prandaj pranoje ndërmjetësimin tim për të. Dhe do të thotë Kur'ani: E kam penguar të flejë gjatë natës, prandaj pranoje ndërmjetësimin tim. Pejgamberi a.s. po thotë: Do të bëjnë mëshirë (shefat) për të”².

Ramazani është sezoni i mi-

rësive që Allahu xh.sh. ia mundëson njeriut. Ai është sezoni i të devotshmëve dhe treg i të mirëve. Kjo botë ka tregtarë, gjithashtu edhe bota tjetër (Ahireti) ka tregtarë. Tregtarët e kësaj bote i presin sezonat e saj që të fitojnë, gjithashtu edhe tregtarët e Ahiretit i presin sezonat e saj që të fitojnë, mirëpo fitimi i tyre s'është i njëjtë. Fitimi i tregtarëve të Ahiretit është falje prej Zotit të tyre dhe xhennete në të cilët rrjedhin lumenj. Tregtarët e Ahiretit janë ashtu siç i ka përshkruar Allahu xh.sh.:

“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zekatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet”³.

Ramazani vjen për çdo vit si

1. El-Bekare, 185.

2. Hadithin e transmeton Ahmedi nga Abdullah ibën Amri r.a.. Gjithashtu e transmetojnë edhe: Taberaniu në “El-Kebir”, Ibën abu Dunja dhe Hakimi.

3. En-Nur, 37.

shans për myslimanin, për t'i shtuar veprat e mira, dhe për t'i pakësuar shkaqet e të këqijave.

Dyert e mirësive dhe të Xhennetit janë të hapura, ndërsa dyert e Xhehennemit janë të mbyllura dhe djajtë janë të prangosur, e kjo është shenjë që mundësitë e mirësisë janë të shumëfishta, ndërsa mundësitë e të këqijave janë të pakta dhe të kufizuara.

Lum për atë që e shfrytëzon këtë mundësi. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Kur të vijë Ramazani, hapen dyert e Xhennetit e mbyllen dyert e Xhehennemit, ndërsa shejtanët prangosen (lidhen me zinxhirë)”¹. Në disa hadithe të tjera, thuhet: “Dhe thërrret një thirrës: O ti që je i prirur për të bërë të mira, afrohu. O ti që je i prirur për të bërë të këqija, zmbrahu”².

Si të jetë agjërimi i saktë?

Që mos të jetë agjërimi yt vetëm agjërim i barkut dhe i ndërprerjeve të marrëdhënieve intime, ndërsa gjuha jote nuk agjëron, sytë e tu nuk agjërojnë, veshët e tu nuk agjërojnë, gjymtyrët e tua nuk agjërojnë.

Syri yt nuk agjëron duke shikuar në haram; gjuha jote nuk agjëron nga gënjeshtria, përgojimi, lloomotitja, tallja e përqeshja apo prej marrëzive; veshi yt nuk agjëron nga dëgjimi i muzikave boshe (që s'kanë dobi) dhe dëgjimit të fjalëve fyese. O mysliman, nuk duhet

1. Hadithin e transmetojnë: Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejra r.a..

2. Pjesë nga hadithi të cilin e transmetojnë: Timridhiu, Ibën Maxhe, Ibën Huzejme në Sahihun e tij dhe Bejhekiu nga Ebu Hurejra r.a..



që të të agjërojnë barku dhe organi gjenital, ndërsa ti i tëri je pa agjërim. Të agjërosh nga ha- jet dhe pijet që i ka lejuar Allahu xh.sh., e të mos agjërosh nga mëkatet që i ka ndaluar Allahu xh.sh.. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Kush nuk i lën fjalët e ndyra dhe përdorimin e tyre (por vepron kështu edhe gjatë Ramazanit), Allahu s'ka nevojë që ai (njeri) ta lejë ushqimin dhe pijen e tij”³. Nuk është rritur me edukatën islame, pasi që nuk e ruan veten e tij nga mëkatet. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Agjërimi është mburojë që e ruan besimtarin nga çdo e keqe, mburojë nga mëkatet dhe gabimet në dynja, dhe nga zjarri në Ahiret. Njëjtë sikur

ndonjëri prej jush të ketë mburojë në luftë). Nëse ndonjëri prej jush agjëron mos të bëjë ndonjë punë të pahijshme e as mos të bërtasë, e nëse dikush e shan (apo ngacmohet) apo dëshiron të rrihet, le të thotë: unë jam njeri që agjëroj”⁴.

Agjëruesi duhet të jetë i qetë, gjakftohtë e i sjellshëm. Duhet ta ruaj gjuhën e tij, ashtu siç i ruan veshët dhe sytë e tij, dhe tërë organet e trupit të tij:

“Ndoshta ai që agjëron nuk përfiton asgjë prej agjëritit të tij vetëm urinë”⁵. E ka lodhur veten dhe trupin e tij, e është përpjekur kot, barku i tij ka mbetur i uritur, mirëpo nuk ia ka dhënë agjëritit të drejtën e tij.

Përpiku që të pastrohesh në

4. Hadithin e transmetojnë: Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejra r.a..

5. Hadithin e transmeton Ibën Maxhe nga Ebu Hurejra r.a..



këtë muaj fisnik, sepse ai është muaj i pastrimit.

Allahu xh.sh. na ka obliguar agjërimin që të lartësohemi në hapësirat e engjëjve, që të lartësohet tek ne pjesa hyjnore-qiellore mbi atë tokësore-baltore. Ai e ka obliguar agjërimin që njeriu me të të ngrihet, që ta ngrejë veten dhe shpirtin e tij, deri sa të bëhet njeri i vërtetë.

Agjërimi të afron tek Allahu xh.sh., sepse ti e ke ndaluar veten tënde nga ajo që e ke patur traditë më parë, për asgjë tjetër jo, por vetëm që Allahu xh.sh. të jetë i kënaqur. Vetëm për hir të Tij, njeriu i le të gjitha ato gjëra që ia dëshiron vetja e tij.

Myslimani në Ramazan lartësohet e pastrohet. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Kush agjëron Ramazanin

me besim dhe përkushtim do t’i falen mëkatet e mëhershme”¹.

“Kush falet në Ramazan me besim (të vërtetë) duke llogaritur (në shpërblimin e Allahut) do t’i falen mëkatet e mëhershme të bëra (ndaj Allahut)”². Do të thotë, do t’i falen mëkatet e vogla siç argumentojnë disa hadithe të tjera, ndërsa për mëkatet e mëdha patjetër duhet pendimi i sinqertë tek Allahu xh.sh.. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Pesë kohët e namazeve, xhumaja deri në xhumanë, nga Ramazani deri në Ramazan bëhen shkak për të falur mëkatet nëse u largohen mëkateve të mëdha”³.

Agjërimi dhe falja e namazeve të shpiejnë tek falja e Allahut xh.sh.. Nëse dëshirosh të dalësh nga ky muaj me mëkate të falura, atëherë duhet që në mënyrë të drejtë të agjërosh dhe të falesh. Duhet të agjërosh dhe të falesh sikur besimtarët të cilët shpresojnë në shpërblimin e Allahut xh.sh..

Prandaj, mjerë për ata që iu vjen Ramazani, e nuk bëjnë dallim ndërmjet tij dhe muajve të tjerë të vitit. Ata janë të cilët quhen me emra myslimanë dhe jetojnë në mesin tonë, po e përdhosin shenjtërinë e këtij muaji fisnik. A lejohet që një gjë e tillë të ndodhë në një shoqëri myslimane? Jo për Zotin. Ata janë ose mëkatarë të mëdhenj, ose renegat (felëshues), Allahu xh.sh. na ruajt prej tyre.

1. Hadithin e transmetojnë: Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejra r.a..

2. Hadithin e transmetojnë: Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejra r.a..

3. Hadithin e transmeton Muslimi nga Ebu Hurejra r.a..

Myslimanët më parë kur agjëronin i shtynin edhe fëmijët e tyre që të agjëronin gjersa ata ishin të vegjël, sa që ndonjëherë u binin lodra fëmijëve të tyre që të loznin deri sa të vije iftari. Pas moshës shtatë vjeçare, nëse fëmija është i fortë dhe mund të agjërojë urdhërohet për agjërim. Ndërsa pas moshës dhjetë vjeçare nëse mund të agjërojë dhe nuk agjëron, atëherë duhet të rrahet nga pak deri sa të agjërojë.

Allahu xh.sh. ia ka lejuar njeriut që të mos agjërojë për arsye të ndryshme, si: sëmundja, udhëtimi, pleqëria, puna e rëndë, u lejohet atyre të mos agjërojnë, mirëpo me kusht që ato ditë të paagjëruara t’i kompensojnë më pas me agjërim, kur të kenë mundësi.

Myslimani duhet të agjërojë prej agimit e gjerë në perëndim të diellit, e kur të perëndojë dielli atëherë ai duhet ta nxitojë iftarin, sepse Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Njerëzit do të gjenden në (rrugë) të mirë aq sa do të nxitojnë me iftarin”⁴. Nxitimi i iftarit dhe vonimi i syfyrit ka qenë nga udhëzimi i Pejgamberit a.s. dhe i shokëve të tij. I Dërguari i Allahut xh.sh. thotë:

“Ne Pejgamberët jemi urdhëruar që të shpejtojmë iftare të vonojmë syfyret tona, dhe ta vendosim dorën e djathtë mbi të majtën në namaz duke u falur”⁵.

“Pejgamberi a.s. para se të falej bënte iftar me ca hurma, e

4. Hadithin e transmetojnë: Buhariu dhe Muslimi nga Sehël Ibën Sa’di r.a..

5. Hadithin e transmeton Taberaniu në «El-Evset».



nëse nuk kishte hurma atëherë pinte ca pika ujë”¹.

Synet është shpejtimi i iftarit dhe vonimi i syfyrit deri para agimit.

Dëshirojmë nga njeriu që gjatë këtij muaji të jetojë me librin e Allahut xh.sh. dhe në mikpritje të tij, sepse Ramazani është muaj i Kur’anit. Njeriu duhet të lexojë sa më shumë nga ky libër, sepse për çdo shkronjë të tij ka shpërbtim të dhjetëfishtë. Duhet ta dëgjojë leximin e Kur’anit, e sa i këndshëm që është namazi i Teravisë kur njeriu e kalon me Kur’anin famëlartë.

Dëshirojmë që Ramazani të jetë një muaj për Allahun xh.sh., prej të cilit njeriu del me faljen e mëkateve dhe me mëshirën e mbrojtjes nga zja-

rri i Xhehennemit. Dëshirojmë që të jetë prej atyre që Allahu xh.sh. i ka liruar prej zjarrit, e Ai për çdo natë liron nga zjarri.

Ky është muaji i Ramazanit, muaj në të cilin Allahu xh.sh. na ka mundësuar që të pastrohemi në të, të pastrohemi nga të këqijat tona dhe të furnizohemi me të mira e të mundahe- mi që ta shtojmë bilancin tonë tek Allahu xh.sh. me të mira.

S’ka gjë të keqe që njeriu ta shtojë pasurinë e tij me fitim të lejuar (hallall), e as nuk kursen që ta shpenzojë atë në obligime, mirëpo më me rëndësi se çdo gjë është pasuria-bilanci që do të jetë në qarkullim në Ditën kur s’ka monedhë tjetër në të, përveç veprave të mira dhe të këqija.

O vëllezër, mundohuni që ta shtoni bilancin tuaj tek Allahu xh.sh. dhe të jetë aktiv. Bëhuni të vendosur që këtë muaj ta bëni të singertë vetëm për Allahun xh.sh., që ta bëni muaj për agjërim, falje, bërjen e veprave të mira, të bëheni bujar për në rrugën e Allahut xh.sh.. Jepni dhe shpërndani zekatin e pasurisë suaj. Kryeni obligimet tuaja, e nëse dikush është borxhli le ta paguaj borxhin e vet.

Kemi nevojë që në këtë muaj të kthehemi tek Allahu xh.sh., ta lusim Atë me zemra të frikësuar e të nderuara, e duart e ngritura kah Ai duke u lutur, që të na shpëtojë nga kjo gjendje që jemi, duke e lutur Atë që të na largoj prej nesh shqetësimet dhe të na zgjidh problemet.

Kemi nevojë që të lutemi, sepse lutja e agjëruetit në kohë

të iftarit nuk kthehet, sikur që është cekur në hadith: “Agjërueti nëse lutet gjatë iftarit, duaaja e tij nuk i kthehet”².

Në një hadith tjetër thuhet: “Lutja e tre lloj personave nuk ju kthehet (u pranohet): agjëruetit kur bën iftar, udhëheqësit të drejtë, dhe lutja e atij që i është bërë padrejtë e ngrit Allahu xh.sh. mbi re, i hapen asaj (lutjes) dyert e qiellit, e thotë Zoti: pasha madhërinë Time do të të ndihmojë që të ngadhënjesh qoftë edhe pas pak”³.

A ka më mirë sesa kur të vije nata nga kjo anë, dhe të shkoj dita nga këtu, e të perëndojë dielli, në këtë kohë jemi përgatitur për iftar, t’i ngremë duart kah Allahu xh.sh. e të lutemi për vetët tona, familjet tona, dhe për mbarë myslimanët kudo që janë, për falje dhe mëshirë, për të dobëtit e të maltretuarit dhe luftëtarët, për çlirim, ngadhënjim dhe shpëtim, e të themi:

“Tku etja e u mbushën damarët, e është vendosur shpërbtim i inshaAllah”⁴.

Përktheu nga gjuha arabe:

Mr. Faruk Ukallo

Burimi: “Ligjëratat e Shejh El-Kardavit”, përgatitur nga Halid Essa’d, mektebetu vehbeh, Kajro, 1997, vëllimi I, faqe: 213-224.

2. Hadithin e transmeton Ibën Maxhe.

3. Hadithin e transmetojnë: Ibën Maxhe, Tirmidhiu, Ahmedi, Ibën Huzejme dhe Ibën Hibbani.

4. Hadithin e transmetojnë: Ebu Davudi dhe Ed-Daru Kutni.

1. Hadithin e transmeton Ebu Davudi nga Enesi r.a.. Gjithashtu e transmetojnë edhe: Tirmidhiu dhe Hakimi.



Ajete

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”

(Bekare: 183)



(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëron), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor) i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për të.



(Bekare: 184)

Muaji i Ramadanit që në të filloi të shpallet Kur’ani, udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues i të vërtetës nga gënjeshttra. E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim dhe nuk dëshiron vështirësim për ju. Të agjëroni më vonë ditët e lëshuara që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun sepse Ai u udhëzoi dhe ta falënderoni Atë.



(Bekare: 185)

Juve u lejohet që gjatë netëve të agjëritit t’i afroheni bashkëshorteve tuaja.

Ato janë petku i juaj, e ju jeni petku i tyre. Perëndia e di mirë se ju nuk mund të duroheni, e keni tradhëtuar veten, e Perëndia u ka pranuar pendimin tuaj dhe u ka falur gabimin.

Prandaj, u lejohet kontakti me bashkëshortet tuaja dhe tani kërkonit atë që ka caktuar Perëndia për ju.

Dhe hani e pini deri në mëngjes (deri në imsak) deri sa të dallohet peri i bardhë nga peri i zi, pastaj plotësoni agjërimin deri në muzg (deri në perëndim të diellit). Mos ju afrohuni atyre gjatë kohës, kur gjendeni në itikaf në xhami! Këta janë kufijt e Perëndisë; pra mos ju afrohuni atyre! Kështu, Perëndia u shpjegon njerëzve dispozitat e veta, që të ruhen e të mos bëjnë punë të ndaluara.

(Bekare: 187)



Hadithe

“Çdo punë e birit të Ademit është e tij me përjashtim të agjërimit,
i cili është i Imi dhe Unë e shpërblej me të ...”

(Buhariu, Muslimi)



Transmetohet nga Ebu Hurejra se Profeti (a.s.) ka thënë: “Agjërimi është mburojë. Kur ndonjëri prej jush agjëron nuk duhet të flasë fjalë (të këqija) dhe të veprojë vepra të pahijshme. Kur dikush e godet apo e shan, le të thotë: “Jam agjërues, jam agjërues.” Pasha Atë në dorën e të cilit është vetja ime, era e gojës së agjëruesit tek Allahu është më e mirë se era e miskut”

(Buhariu, Muslimi)



Hudhejfe ka thënë se ka dëgjuar Profetin (a.s.) të thotë: “Sprovën e personit në familjen e tij, pasurinë e tij, fqinjin e tij, e fshin namazi, agjërimi dhe sadakaja”

(Buhariu dhe Muslimi)



Transmetohet nga Sehl, i cili rrëfen se Profeti (a.s.) ka thënë: “Në xhenet ka një derë që quhet Rejhan. Në ditën e Kiametit futen prej saj vetëm agjëruesit dhe nuk futen në të tjetër veç tyre. U thuhet: ‘Ku janë agjëruesit?’ Kur futen ajo mbyllet dhe nuk futet tjetër veç tyre”.

(Buhariu dhe Muslimi)



Ebu Hurejra rrëfen se Profeti (a.s.) ka thënë: “Kur vjen Ramazani hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe shejtanët lidhen”

(Buhariu dhe Muslimi)



Ebu Hurejra rrëfen se Profeti (a.s.) ka thënë: “Kush ngrihet Natën e Kadrit me besim dhe përkushtim i falen atij gjynahet e kaluara. Kush agjëron me besim dhe përkushtim i falen atij gjynahet e kaluara”

(Buhariu dhe Muslimi)



“Çdo punë e birit të Ademit është për të, shpërblehet prej dhjetë deri në shtatqind herë më shumë, përveç agjërimit, që në të vërtetë është vetëm për Mua dhe unë e shpërblejë për të, e lë epshin e vet dhe ushqimin e tij vetëm për Mua. Agjëruesi ka dy gëzime: një gëzim e ka kur të bëjë iftar dhe tjetrin kur të takoj All-llahun”

(Muttefekun Alejh)



“Agjërimi dhe Kur’ani ndërmjetësojnë për robin në ditën e gjykimit. Agjërimi thotë: O All-llah, i kam larguar ata nga ushqimi dhe kënaqësitë pra mundësoma mua që të ndërmjetësoj për të. Poashtu edhe Kur’ani thotë: O All-llah i kam ndaluar ata nga gjumi i natës, prandaj mundësoma mua që të ndërmjetësoj për ta. All-llahu (xh.sh.) ua mundëson që të dyve”

(Ahmedi)



Nga Ebu Hurejre (r.a.) transmetohet se ky e ka pyetur Pejgamberin Muhamed (a.s.) : Cila është vepra më e mirë? Ka thënë: “Agjëro, me agjërimin nuk ka të barabartë.”



(Nesai)



Ramazani i bekuar: Edukata shpirtërore e një jete të tërë

Zoti ynë, ka caktuar në kalendarin e jetës stinët e fitimit shpirtëror në të cilat shpërthejnë ngado mëshira, falja dhe butësia hyjnore në mënyrë që njerëzit të kenë fatin të fitojnë lumturinë e përhershme. Stina më e begatë prej tyre është pa dyshim muaji i bekuar i Ramazanit. Arsyet janë:

- Kurani Fisnik, udhërrëfyesi ynë drejt të

vërtetës, u shpall në këtë muaj të bekuar.

- Adhurimi i agjërimit, pretekst për një pjekje shpirtërore të veçantë, është caktuar të kryhet në këtë muaj.

- Nata e Kadrit, që është më e bekuar dhe e vyer sesa një mijë muaj, është dhuruar netëve të Ramazanit.

- Netët dhe mbrëmjet në këtë muaj janë begatuar me anë të namazeve të teravive dhe ngrënjes së syfyreve.

- Shpirtrat e plagosur që përdridhen mes lloj-lloj nevojash dhe privimesh zhyten më shumë se kurrë se në këtë muaj brenda ndjenjave të shpresës dhe gëzimit. Zeqati, sadakaja dhe dhurimi bëjnë që në sa e sa fytyra njerëzish të shfaqet sërish buzëqeshja, të cilën kishin vite që nuk e kujtonin.

- Në këtë muaj çelen portat e madhështive shpirtërore dhe dyert e xhenetit.

- Në këtë muaj mbyllen dyert e xhehenemit pasi që njerëzit ruhen më shumë nga gjynahet dhe distancohen më shumë nga kryerja e veprave të këqija.

- Shejtanët dhe ndihmësit e tyre lidhen me vargonjtë e devotshmërisë së njerëzve të përkryer shpirtërisht.

Kështu, muaji i Ramazanit, i cili u hap be-





“Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin u shpall Kurani me argumente të qarta që u rrëfen udhën njerëzve dhe dallon të drejtën nga e shtrëmbërta. Ata që e mbërrijnë këtë muaj le të agjërojnë...”

(Bekare, 185)



simtarëve portat e lumturisë së përhjetshme, nëjkohësisht cel shtigjet e ardhmërisë për mbarë umetin mysliman.

Kurani dhe Ramazani

Allahu në Kuran thotë:

“Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin u shpall Kurani me argumente të qarta që u rrëfen udhën njerëzve dhe dallon të drejtën nga e shtrëmbërta. Ata që e mbërrijnë këtë muaj le të agjërojnë...” (el-Bakara, 185)

Pasi mësojmë nga ky ajet se Kurani u shpall në muajin e Ramazanit dhe se ai është një libër i mbushur me dritat e urtësive dhe të vërtetave me anë të të cilave mund të ndahet e vërteta nga e gënjeshtërtja dhe e mira nga e keqja, bëhet e qartë se myslimanët që e mbërrijnë këtë muaj të bekuar janë të detyruar që të agjërojnë nën edukatën e Kuranit.

Nga ky aspekt, është e domosdoshme për një besimtar që ai të kuptojë afërsinë e thellë dhe lidhjen e hollë që ekziston në mes librit të shenjtë Kuranit dhe muajit të Ramazanit.

Abdullah bin Abbas rrëfen:

“I dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.) që njeriu më bujar. Koha që ai e shtonte masën e bujarisë së tij qenë kohët kur ai takohej me engjëllin Xhebrail. Xhebraili takohej cdo

mbrëmje të Ramazanit me të dhe i lexonin njëri-tjetrit pjesë nga Kurani. Për këtë arsye kur Profeti takohej me Xhebrailin sillej më shumë se çdo herë tjetër me bujari ashtu si era që fryn pa hasur në ndonjë pengesë.” (Buhari, Bedu’l-Vahj 5, 6, Savm 7; Muslim, Fedail 48, 50)

Ne duhet ta perceptojmë qartë imperativin shpirtëror që përcjell kjo e vërtetë dhe si shprehje të këtij perceptimi, në mënyrë që të përfitojmë ashtu siç i ka hije nga frymëzimi dhe begatia e Ramazanit të bekuar, në mënyrë të vecantë, në muajin e Ramazanit, ne duhet të merremi më shumë me leximin dhe meditimin rreth ajeteve të Kuranit.

Në thelb, ne duhet të tregohemi më të zellshëm që ta shtojmë leximin e Kuranit ditëve të këtij muaji të bekuar, lexim i cili duhet të jetë se s’bën pjesë e çdonjëres prej njëzet e katër orëve të ditës së besimtarit. Duke u përfshirë brenda klimës shpirtërore të tij, si domosdoshmëri e kësaj përfshirjeje, ne duhet të përpiqemi që të punojmë sipas tij dhe t’i fshijmë të metat tona duke mbajtur si peshore përpara nesh në lidhje me sjelljen dhe veprimet tona të përditshme këto urdhëresa hyjnore.

Prehja e individit dhe e shoqërisë realizohet atëherë kur ata hyjnë brenda jetës shpirtërore të Kuranit. Kurani është një dritë hyjnore që ndriçon botën e brendshme dhe të jashtme të



besimtarit. Ai është udhërrëfyesi i lumturisë së përjetshme që e shpie njeriun drejt të Vërtetës duke e udhëzuar atë përmes mësimesh, urtësish dhe rrëfimesh të vërteta.

Cili zë tjetër përvec tingullit Kuranor mund ta shpie drejt prehjes, qetësisë dhe kënaqësisë “udhëtarin drejt përjetësisë” i cili ka mbetur ngushtë mes të panjohurave të jetës dhe të së ardhmes dhe i tronditur nga shqetësimet dhe krizat shpirtërore që i shkaktojnë filozofitë e përziera të kësaj bote?

Nuk ka sgjë tjetër përvec përmbajtjes së thellë të mesazheve kuranore që do ta ngushëllonte njeriun që e kanë zënë baticat dhe zbatat e kësaj jete kalimtare dhe që do ti servirte prehjen e lumturisë së përjetshme mendjeve të zëna ngushtë mes dy gurëve të varreve.

Rasti i Ramazanit në begatinë e jetës

Zoti ynë, betohet mbi kohën në Kuranin fisnik, duke na kujtuar se lumi i jetës është duke vërshuar me të shpejtë dhe se jeta jonë tem-

porale është duke u fikur me një ritëm shumë të shpejtë. Ai na e bën të qartë se jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër vetëm se një periudhë e shkurtër e kohës dhe se jeta e vërtetë është jeta në botën tjetër, ahiret. Në këtë mënyrë ai na tërheq vëmendjen nga gjendja e indiferencës në të cilën mund të bie besimtari. Për këtë arsye besimtari:

- Duhet të meditojë rëndësinë e begatisë së kohës që Allahu na ka dhuruar dhe të përpiqet me zell që ta vlerësojë atë në mënyrën më të bekuar në drejtim të synimeve më të vyer.

- Duhet ta perceptojë nevojshmërinë e jetës që duhet të kalohet me njerëzit që kryejnë vepra të mira.

- Duhet të nxitojë të bëjë dua dhe pendesë përpara se të mbushet koha e afatit të sigurisë për jetën.

Duhet të mendohet se, jeta e kësaj bote që konsiston nga ditë të caktuara i ngjason aq shumë edhe muajit të Ramazanit që përbëhet

nga një numër i caktuar ditësh. Nga ky kontestim, besimtari duhet ta mbaj gjallë me kujdes dhe përpikmëri të madhe muajin e Ramazanit që përbën një stinë fitimi dhe dhuntie të rrallë shpirtërore.

Aishja tregon:

“I dërguari i Allahut, gjatë muajit të Ramazanit tregonte një zell të paparë në jetën e tij fetare dhe adhurimeve në krahasim me muajt e tjerë. Në mënyrë të vecantë në dhjetë ditët e fundit të muajit të Ramazanit ai jepej edhe më shumë pas adhurimeve. Gjatë këtyre dhjetë ditëve i kalonte netët zgjuar, e zgjonte familjen e tij dhe e kalonin kohën me adhurime.” (Buhari, Fadlu Lejleti'l-Kadr, 5; Muslim, Itikaf, 8)

Ata që i kalojnë ditët dhe netët e muajit Ramazan ashtu sic i ka hije atij përfitojnë begati të panumërta. Ata që tregohen moskokçarës ndaj tij do të bien viktimë të privimeve të tmerrshme në këtë jetë dhe në jetën tjetër, sepse edhe në hadithin fisnik profeti Muhamed (a.s.) thotë:

“Mu shfaq përpara Xhebraili dhe më tha: *Larguar qoftë nga mëshira personi që e mbërrin muajin e Ramazanit dhe nuk i falen mëkatet me këtë rast ...*” (Hakim, IV, 170/7256; Tirmidhi, Davat, 100/3545)

Kapu pas agjërimit ...

Pika që duhet treguar më së shumti kujdes dhe duhet kryer siç i ka hije gjatë muajit të Ramazanit është pa dyshim adhurimi i agjërimit.

Edukata e besimtarit që realizohet në sajë të privimit nga disa begati të kësaj jete, por nën botën e përshtirshme të Kuranit, është njëkohësisht sihariqi i begative të përhershme të xhenetit.

Kur Ebu Uame e pyeti një ditë profetin Muhamed ta këshillonte të kryente një vepër nëpërmjet të cilës Allahu do ta shpërblente pa masë, i dërguari i Allahut iu përgjigj:

– *Të këshilloj të kapesh pas agjërimit, sepse ai është adhurimi që nuk ka të ngjashëm për nga*

vlera dhe shpërblimi. (Nesai, Sijam, 43)

Profeti e shprehte me këto fjalë vlerën e lartë të syfyreve:

– *Bëni syfyr qoftë edhe me një gllënkë ujë*” (Abdurrezak, Musannef, IV, 227/7599)


– *Mos e lini pa ngrënë syfyryn, sepse në kohën e syfyrit zbret begatia.* (Buhari, Savm, 20)

Agjërimi i Ramazanit është edukata e përdorimit edhe i gjërave që janë hallall në jetën të përditshme në një mënyrë të përkorë. Kjo situatë na mëson neve se sa shumë dhe me sa përpikmëri duhet t’u shmangemi haramëve dhe gjërave të dyshimta.

Abdullah bin Umer rrëfen:

“Allahu nuk do ta pranojë adhurimin e namazit që falni, edhe poqese për shkak të tij do të bëheshit si hark nga përkuljet, as adhurimin e agjërimit, edhe poqese për shkak të tij do të shkriheshit dhe dobësoheshit si gozhdë, përderisa ju të mos i shmangeni haramëve dhe gjërave të dyshimta.”

Sa bukur shprehet Mevlana rreth këtij as-





pekti edukativ të agjërimit në çështjen e ruajtjes nga harami dhe gjërat e dyshimta:

“Agjërimi thotë:– Allahu im! Ky njeri nuk pranoi të shtinte në gojë kafshatën e fituar hallall duke iu bindur urdhrin Tënd. Nuk piu asnjë pikë ujë megjithëse etja ia përvejlonte buzët. E si mundet ky njeri të zgjas dorë drejt haramit?!”

Pra, agjërimi është një disiplinim shpirtëror që mban nën të përbindëshin nefs që gjendet brenda çdo njeriu dhe përgatit truallin për shfaqjen e ndjenjave të mëshirës dhe zemërbutësisë, që janë të fshehura brenda natyrës njerëzore.

Me të vërtetë, sa ndërgjegjësim sublim i shpirtit të besimtarit është agjërimi që na mëson rreth vlerës së begative, na shtyn drejt falënderimit dhe lavdërimit të Zotit, na mëson të kuptojmë jetën e nevojtarëve, zgjon në zemra shpërthimet e mëshirës ndaj klithmave “tu vijë keq për ne” që lëshojnë të varfrit, që ngre zemërbutësinë dhe mëshirën mbi gjithë dashuritë e tjera të kësaj jete dhe që ngjall ndjenjën e ndihmës ndaj të papërkrahurve dhe të mjerëve. Sa shkollë e bukur edukimi

është agjërimi i cili shuan furtunën e pangopësisë në zemra dhe më në fund u mëson atyre virtytin e durimit.

Aspekti më i rëndësishëm i kësaj shkolle që edukon shpirtin nuk ka dyshim se është një sërë sprovash dhe provimesh me të cilat ai e lë ballë për ballë individin. Njeriu arrin t’i afrohet të vërtetës së agjërimit në atë masë që i përgjigjet pozitivisht këtyre provave dhe në atë shkallë që arrin të kalojë me durim pengesat që i dalin përpara.

Një nga këto provime që duhet kaluar me durim ndërsa jemi agjërueshëm shprehet me këto fjalë në hadithin fisnik:

“Askush nga ju të mos thotë ndonjë fjalë të pahijshme apo të grindet me kënd ditën që të jetë agjërueshëm. Nëqoftëse ndokush e fyen apo kërkon të zihet me të atëherë le t’i thotë: “Unë kam agjëruar sot.”” (Buhari, Savm, 9)

Në fakt grindja dhe debati armiqësor mes njerëzve janë dy sjellje të qortueshme në cdo kohë. Për më tepër, kur një besimtar që ka agjëruar fëlliqtet me një shëmtirësi të tillë,

atëherë do të grisët dhe perdja shpirtërore e agjërimit që mban dhe do të zhduket edhe frymëzimi i këtij adhurimi. Qëndrimi që duhet të mbajë përherë besimtari në këto raste është ajo që na mëson Zoti ynë kur thotë:

“Robërit e vërtetë të Mëshiruesit janë ata që shkojnë rrugës me modesti dhe kur njerëzit e pafatë u drejtojnë fjalë për t’i fyer ata u përgjigjen: Paqe, dhe mjaftohen me këtë fjalë.” (Furkan, 63)

Për këtë arsye, adhurimi i agjërimit duhet të kryhet të pushtuar nga një thellësi shpirtërore, duke hequr dorë nga gjërat që nuk i përkasin besimtarit, me hijeshi dhe përpikmëri. Vetëm se, nuk mbahet një agjërim i përkryer vetëm duke e mbajtur të zbrazët stomakun. Agjërimi i pranuar kushtëzon vënien në komandë të nefsit në mënyrë që të gjithë gjymtyrët e trupit të mbrohen dhe ruhen nga haramet dhe gjërat e dyshimta.

Skllavi i liruar i të dërguarit të Allahut, Ubejdi, rrëfen:

Dy gratë kishin agjëruar. Nga koha e drekës erdhi një person që tha:

– O Resulullah! Atje janë dy gra që kanë mbajtur agjërim. Përpaksa nuk do të vdesin nga etja. Jepuni leje dhe ta prishin agjërimin.

I dërguari i Allahut i ktheu shpinën dhe nuk i dha përgjigje. Personi e përsëriti sërish të njëjtën gjë:

– O profet i Allahut! Për Zotin, për pak sa nuk do të vdesin.

Profeti (a.s.) urdhëroi që t’i njoftonin ato gra të afroheshin tek vendi ku ata qëndronin dhe kur ato erdhën Muhamedi (a.s.) kërkoi t’i sillnin një enë.

Ai ia dha enën njërës prej tyre dhe i tha:

– Nxirre përjashta atë që ke brenda!

Gruja volli nga goja gjak, copëza mishi dhe qelbi aq sa e mbushi në gjysëm enën. Kur profeti e urdhëroi gruan tjetër që të bënte të

njëjtën gjë, e dyta volli nga goja qumësht dhe mish i freskët. Pas kësaj që ndodhi profeti Muhamed (a.s.) tha:

– Këto gra u përmbajtën përpara gjërave që Allahu ua ka lejuar në jetën e përditshme duke mbajtur agjërim, por kur erdhi koha ta prishin agjërimin ato e prishën atë me ato gjëra që Allahu ua ka ndaluar, sepse u ulën pranë njëra-tjetrës dhe filluan të marrin nëpër gojë njerëzit e tjerë. (Ahmed, V, 431; Hejthem, III, 171)

Nga ky hadith mësojmë se ashtu siç duhet të tregohemi të kujdesshëm që të mos shtiem gjë në gojë ndërkohë që jemi duke agjëruar, po ashtu duhet të tregohemi të kujdesshëm edhe për cdo fjalë që mund të na dal nga goja. Gjuha nuk duhet të jetë si një gjemb që ngulet në zemër, por gjuha e mëshirës. Për të mundur të jetojmë një jetë të vërtetë dhe të mbushur me frymëzim hyjnor gjatë muajit të Ramazanit duhet të zotërojmë një shpirt të ndjeshëm të mbrujtur me urtësitë e Kuranit dhe një fytyrë të qeshur që reflekton fytyrën e vërtetë të mësimave islame.



Robëria e singertë ndaj Zotit

Ramazani i bekuar është në të njëjtën kohë edukata e bukur e të qenit rob i Zotit. Ata që nuk janë robërit e singertë të Allahut përfundojnë të bien në një fund të keq duke u shndërruar në robër të njerëzve të tjerë, që do të thotë për një njeri të çoj dëm nderin dhe personalitetin e tij njerëzor.

Perceptimi dhe përjetimi siç i ka hije Ramazanit, është e lidhur vetëm me të jetuarit nën vetëdijen e “robërisë ndaj Allahut” duke u thelluar brenda të vërtetës së tevhidit. Për këtë arsye ne duhet të përpiqemi të ngjism sa më shumë shkallë në jetën tonë shpirtërore vecanërisht gjatë muajit të begatë të Ramazanit.

Kjo arrihet vetëm nëpërmjet “singeritetit”, sepse vetëm singeriteti, zemra e pastër dhe qëllimi i kulluar e rrisin perfeksionimin e adhurimeve. Nuk mund të pritet e mirë nga adhurimet në të cilat janë përzier edhe mendimet personale për fitimin e të mirave të kësaj bote dhe në të cilat marrin pjesë edhe synime të tjera përveç fitimit të pëlqimit të

Allahut.

Në një hadith fisnik thuhet:

“Sa e sa agjërues nuk përfitojnë nga agjërimi i tyre gjë tjetër përveç se rrijnë me barkun bosh. Sa e sa besimtar që i kalojnë netët me faljen e namazeve, nuk përfitojnë nga namazet e tyre asgjë përveç se mbeten pa gjumë.” (Ibn Maxhe, Sijam, 21)

Veprat që nuk të shpien deri tek kënaqësia e Allahut dhe nuk shndërrohen në kapital të lumturisë së ahiretit paraqesin rrezikshmërinë e çuarjes dëm të ardhmërisë së përjetshme. Të nisësh udhës së ahiretit pa u pajisur më parë me ushqimin shpirtëror që të nevojitet është shkaku që të shpie në humbjen dhe shkatërrimin më të madh. Adhurimet që nuk kryhen me singeritet dhe përshpirtshmëri bëjnë që në ahiret njeriu të mbetet duarbosh nga sevapet.

Adhurimet e kryera gjatë muajit të fitimit madhor shpirtëror të Ramazanit duhet të shndërrohen jo vetëm në domosdoshmëri shprehije dhe tradite specifike për këtë muaj,

por duhen duhen kryer me ndërgjegjsimin e pastër të robit ndaj Zotit. Në të kundërt, adhurimet e humbasin përshpirtshmërinë, agjërimi që mbajmë i përngjan më shumë një perhize se sa një adhurimi, ndërsa namazet e teravive të falura sa më shpejt të jetë e mundur shndërrohen vetëm në mjet që të tresim sa më shpejt ushqimin e iftarit.

Për të përfituar ashtu siç i ka hije nga muaji i Ramazanit, fillimi i të cilit është mëshirë, mesi, falje gabimesh dhe fundi, shkak për shpëtimin nga xhehenemi duhet që besimtari t'i kryejë adhurimet e tij me sinqeritet dhe zemër të pastër dhe me sa të kemi mundësi t'i shtojmë ato. Sepse, veprat që kryhen gjatë kësaj stine të përfitimit shpirtëror mund të jetë parapërgatitja jonë më e mirë dhe më e vyer e udhëtimit tonë për në botën tjetër.

Profeti ynë Muhamedi (a.s.) na ka mësuar se adhurimet do të na shoqërojnë edhe në jetën tonë të varrit duke thënë se:

“Kur të vdes besimtari namazi do t'i rrijë mbi kokë, zeqati në të djathtë, ndërsa agjërimi në të majtë.” (Hejthemi, III, 51).

Prandaj, ashtu sic i ka vlerësuar Zoti ynë të gjithë kohët e vitit me ardhjen e muajit të Ramazanit, ne duhet ta perceptojmë dhe ringjallim jetën tonë me hijeshinë, elegancën dhe hollësinë e muajit të Ramazanit, duke shpresuar në frymëzimin dhe begatinë që zbret gjatë tij. Nuk duhet t'i harrojmë asnjëherë kujtimet shpirtërore që mund të kalohen nën edukatën e muajit të Ramzanit. Sa do e gjatë të duket jeta, ajo është edhe më e shkurtër se stina një mujore e Ramazanit, përballë jetës së përhershme të ahiretit.

Zoti ynë i pranoftë adhurimet dhe veprat e mira që do të bëjmë për hir të kësaj stine të begatë dhe këtyre kohëve të bekuara. Na e bëftë të mundur që këtë muaj të Ramazanit që e mbërritëm ta zgjasim deri në ardhjen e Ramazanit të vitit tjetër me anë të qëllimeve të sinqerta dhe të kriterëve të devotshmërisë në mënyrë që një jetë të tërë të mund ta kalojmë brenda përshpirtshmërisë së muajit të Ramazanit.

Amin...

MUDAREBEH

NJË ORGANIZIM BIZNESI!!!



"Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për nëpunësit e zekatit..."

(Tevbe: 60).



HYRJE

Mudarebeh është një marrëdhënie ndërmjet dy ose më shumë personash, ku një ose më shumë persona ofrojnë kapitalin, ndërsa të tjerët udhëheqin biznesin në emër të atij ose të atyre me një përqindje fitimi për të cilën kanë rënë dakord.¹

Ky përkufizim i kësaj forme të veprimtari të biznesit në islam na tregon qartë se në

1. Hyrje në ekonomi dhe financa islame, grup autorësh, Prishtinë, 2008, f.249

ditët tona moderne gjen një përmbajtje më të thellë të saj në të gjitha aspektet e ekonomisë. Në ditët tona, ka nevojë më së shumti për aplikim të këtyre formave të organizimit të biznesit të cilat nuk bien ndesh me sheriatin. Domosdoshmëri janë këto forma të organizimit të biznesit kur kemi parasysh krizën financiare botërore e cila sot si kancer është shtrirë në të katër anët e rruzullit tokësor. Por, disa qëllimisht këtë formë të organizimit të biznesit

e lidhin me kamatën e cila ligjërisht sipas sheriatit islam është e ndaluar. Por, në fakt, persona të këtillë nuk kanë asnjë argument shkencor e logjik se një formë e këtillë e organizimit të biznesit d.t.th. edhe një implikim i kamatës në veprimtari.

Ekzistojnë shumë përkufizime të kësaj forme të biznesit. Në mesin e këtyre përkufizimeve do të përmendim disa prej tyre.

Mudarabah është marrë-

veshja ndërmjet dy palëve që përfundon me ndarjen e fitimit pas përfundimit të projektit. Njëra palë përfaqëson kapitalin si udhëheqës, ndërsa pala tjetër përfaqëson agjentin. Mudarabaha mund të specifikohet sipas karakterit të thjeshtë. Marrëveshja Mudarabah përfaqëson një marrëveshje të besimit sipas së cilës partneri aktiv menaxheri i ri, ai nuk garanton për problemet që lindin, vetëm në rast të mallverzimit, thyerjes së obligimeve ose delikuençë.¹

Mudarabah gjithashtu quhet edhe kirad. Kjo është kontratë e ndarjes së fitimit dhe humbjes. Në këtë kontratë njëra palë ofron kapitalin, ndërsa pala tjetër menaxhon ndërmarrjen. Nëse ka humbje, pronari i kapitalit pëson humbje në financa, ndërsa menaxhuesi pëson humbje në punë. Nëse ka fitim të dyja palët ndajnë fitimin sipas marrëveshjes.²

Dijetarët mysliman këtë formë të organizimit të biznesit e kanë definuar edhe si: "Marrëveshje midis dy palëve në mënyrë të atillë që njëri t'i japë tjetrit para për të bërë tregti për të fituar një përqindje nga fitimi i realizuar".³

Në këtë formë të organizimit të biznesit në fakt ekzistojnë pronari dhe përfa-

1. Banka islame, artikull i përkthyer nga gjuha boshnjake. Përktheu: Hamdi Nuhiju burimi i artikullit http://bbi.ba/razlike/razlike_bos.htm

2. Ekonomia islame (revistë shkencore periodike), nr.1 viti 2006, f.51

3. Kamata lufta me Allahun, Muhamed bin Salih el Uthejmin, Ahmed es Salus, Tiranë, 2004, f.58

qësuesi i pasurisë së pronarit i cili punon në emër dhe për llogari të pronarit të vet, por me një përqindje të caktuar në fitim. Përfaqësimi në Islam është një gjë e cila është e ligjëruar dhe nuk është e ndaluar.

Përfaqësimi është autorizimi i tjetërkujt që të veprojë në vend të autorizuesit në kontratat ku lejohet zëvendësimi. Përfaqësimi është i lejuar dhe i ligjshëm. Allahu thotë: **"Dërgoni njërin prej jush në qytet me këtë monedhë argjendi tuajën.."** (Kehf:19). Në ajetin tjetër i Lartësuar Allahu thotë: **"Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për nëpunësit e zekatit..."** (Tevbe:60). Këtu Allahu ka lejuar që dikush tjetër ta tubojë zekatin, si përfaqësues i atyre që e meritojnë ta marrin atë. Nga Xhabiri r.a. transmetohet të ketë thënë: Desha të nisem për në Hajber dhe Pejgamberi s.a.v.s. më tha: "Nëse e takon përfaqësuesin tim, merr prej tij pesëmbëdhjetë barrë..." Nga Urve Ibnul Xhađi r.a. transmetohet të ketë thënë: I Dërguari i Allahut a.s. dëgjoi për një mall të importuar. Më dha mua një dinar dhe më

tha: "Urve! Shko tek ai mall i importuar dhe na e blejë një dele..."

Të gjithë myslimanët kanë konsensus se përfaqësimi lejohet në përgjithësi, sepse është i nevojshëm dhe secili njeri vetë nuk mund ta bëjë secilën gjë për të cilën ka nevojë dhe prania e nevojës ka kërkuar që kjo të jetë e ligjshme.⁴

Mudarebe sipas Ebu Bekr el Xhezairit është formë e organizimit të biznesit kur një person i jep një tjetri një sasi të caktuar pasurie për të bërë tregti, dhe fitimin e ndajnë ashtu si janë marrë vesh më parë, ndërsa humbjen, nëse ka, e ndajnë vetëm në varësi të kapitalit, pasi punëtorit i mjafton humbja e mundit të tij dhe nuk i ngarkohet humbje tjetër.⁵

Ekzistojnë edhe definicione të kësaj forme të organizimit të biznesit, por ne do të ndalemi me kaq në këtë pjesë të trajtesës sonë duke u zgjeruar më vonë në disa seg-

4. Shpjegim i shkurtër i legjislaturës islame, grup dijetarësh, Shkup, 2008, f.283

5. Minhaxh el Muslim, Ebu Bekr el Xhezairi, Tiranë, 2005, f.398



mente më të rëndësishme të kësaj forme të organizimit të biznesit. Është me rëndësi të dimë se çdo veprim dhe çdo tentim për të vepruar në biznes sipas rregullave të sheriatit na sjell dobi neve në këtë botë, por edhe ai veprim për ne është një veprim ibadeti për të cilin shpërblehemi tek Allahu i Madhërishëm.

NEVOJA PËR ORGANIZIM BIZNESI

Gjatë gjithë historisë së njerëzimit kanë ekzistuar nevoja eksplicite për organizim biznesi. Por padrejtësitë janë njohur mû në rastet e organizimeve të këtilla të cilat kanë shtresuar shoqërinë njerëzore në klasa. Përderisa shoqëria njerëzore ka qenë e shtresuar në klasa, atëherë kanë lindur padrejtësi të ndryshme ku më i forti ka shfrytëzuar

më të dobët. Në këtë mënyrë me kalimin e kohës dhe zhvillimin e mjeteve tekniko-teknologjike logjika e shfrytëzimit të mundit të tjetërkujt për interesa vetjake asnjëherë nuk është shuar. Bile ajo logjikë është ushqyer sistematikisht me ide dhe mendime të reja të cilat i kanë hapur dyert e njerëzve të padrejtë që të veprojnë në kundërshtim me të gjitha rregullat etike dhe morale në rruzullin tokësor. Gjatë periudhave të krizave ekonomike, njerëzimi ka nevojë për një unitet në biznes. Kjo ngase në këto periudha cenohet vet ekzistenca e tyre. Përderisa ekzistenca e njerëzimit cenohet në periudha të krizës ekonomike, atëherë nevoja për organizime të biznesit është imanente. Vet udhëheqësi i myslimanëve Omer Ibn Hatabi në periudha krizash nuk ka dënuar vjedhësit. Kjo për arsye se gjendja ishte e jashtëzakonshme dhe nuk kishte një logjikë ose mënyrë se si të mënjanohej për një mënyrë më të shpejt vet kriza ekonomike.

Problemi ekonomik i qenieve njerëzore konsiston në 'plotësimin e nevojave' me anë të resurseve që janë në disponim, të cilat mund të mungojnë në raport me nevojat.

Nëse zvogëlohet kufizimi i resurseve, atëherë nevojat njerëzore mund të plotësohen ashtu siç janë objektivisht të definuara.¹

1. Mendimet ekonomike islame 1, grup autorësh, Tetovë, 2002, f.82

Ibn Kajimi në librin e tij "Dobi të reja", pasi ka parqitur mendimet e të parëve tanë të mirë në lidhje me fjalën begati e cila është e domosdoshme për tû poseduar në ditët tona, më pastaj ka thënë: "Fjala 'begati' nënkupton bollëkun e mirësisë dhe vazhdimësinë e saj. Askush përveç Allahut nuk e meriton të cilësohet dhe ta dhurojë atë. Ai është më i Madhërishmi dhe më i Larti. Komenti që i bëjnë të parët tanë të mirë kësaj fjale, vërtitet rreth kësaj që thamë, bollëkut të mirësisë dhe vazhdimësisë së saj. Këto dy fjalë duhet të jenë të pandashme në këtë rast, sepse vetëm në këtë mënyrë mund ta japin të plotë kuptimin e fjalës begati."²

Ndërsa në ditët tona është bërë domosdoshmëri që të aplikohet kjo formë e biznesit dhe të gjitha format e tjera të ligjëruara sipas sheriatit islam. Pasi që resurset në rruzullin tokësor janë shumë të rralla, mjetet për investime nuk ekzistojnë, pasi që jemi në krizë ekonomike, ndërsa pasuria është e ndarë padrejtësisht dhe e koncentruar vetëm te një grup njerëzish. Në momentet e krizave ekonomike njerëzit që merren me biznes janë të destinuar që të krijojnë monopole dhe të haperojnë në treg në formë jo luajale. Është e domosdoshme që të aplikohet një formë kontrolli mbi këto dukuri të cilat janë të përhapura në të katër anët e rruzullit tokësor. Sot numri i të papunëve

2. Kërkimi i begatisë, Nasir ibën Muha - med el Xhedi, Tiranë, 2007, f.37

në shumë vende të rruzullit tokësor është tmerrësisht i madh. Edhe pse janë të kualifikuar me një diplomë universitare shumica e të rinjve nuk dinë se si t'ia bëjnë dhe në çfarë forme ta përballojnë krizën e cila ka kapluar komplet rruzullin tokësor. Forma e organizimit mudarebe, ku ai që posedon pasurinë e mban në dry ose të mbyllur ose në rezerva dhe nuk e investon duke iu frikësuar humbjeve, ndërsa sot shumë të rinj bredhin rrugëve lart e poshtë duke kërkuar zgjidhje për hallet e tyre ekonomike, është një formë biznesi e cila më së lehti mund të zgjidhë problemet e shoqërisë tonë.

DISA KARAKTERISTIKA TË KËSAJ MARRËVESHJE

Në këtë marrëveshje ekzistojnë shumë palë. Sipas kësaj nuk është patjetër që të jetë marrëveshje dy palëshe dhe nuk është një investim i kapitalit në rrugë jo të drejta.

Sipas sheriatit lejohet që kjo marrëveshje të bëhet midis myslimanëve dhe jo myslimanëve. Por, në kohët tona moderne është e preferuar dhe e domosdoshme që një marrëveshje të këtillë të riptërijë bashkëpunimin midis myslimanëve në sferën e biznesit.

Ekzistojnë disa kriteret dhe obligime të cilat përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve në këtë lloj të veprimtarisë biznesit.

Shkurtimisht do t'i përme-ndim disa prej tyre.



Koncepti i përgjegjësisë në mudarebeh është shumë i njëjtë me atë të pronësisë. E tërë situata mund të shpallet përsëri thjesht si vijon:

Përgjegjësia e pronarit të jetë deri në masën e kapitalit të tij total, përveç nëse ai zotohet për një hua të cilën ai nuk mundet ta paguajë nga kapitali. Në këtë rast, ai do të jetë deri në masën e huasë së tij.

Në rast të mudarebesë, nëse sipërmarrësi blen mallra me kredi që e tejkalojnë totalin e kapitalit të biznesit me pëlqimin e pronarit, pronari dhe sipërmarrësi do të konsiderohen përgjegjës për të paguar borxhin.

Secili fitim ose humbje në

paratë e marra me hua përtej totalit të kapitalit të biznesit do të ndahet mes pronarit dhe sipërmarrësit në mënyrë të barabartë dhe jo me përqindje sipas marrëveshjes në kontratën e mudarabesë për shkak se:

- kontrata e mudarabesë nuk është për kapital të huazuar;

- blerja e mallrave me kredi nga ana e sipërmarrësit do të thotë se për këtë pjesë të kapitalit ai është në partneritet me pronarin. Ky është një lloj partneriteti, ku të dy ose të gjithë partnerët nuk paraqesin asnjë kapital, por speku-lojnë me kapitalin e huazuar. Meqë të dy janë të barabartë në lidhje me këtë, ata do të jenë të barabartë në çdo fitim



ose humbje po ashtu. Pra, deri në masën sa huazohet kapitali, fitimi ose humbja do të ndahet nga pronari dhe ndërmarrësi në mënyrë të barabartë.

- nëse pronari dëshiron ta zgjerojë biznesin, qasja e drejtë për të do të jetë të huazojë para nga jashtë dhe pastaj t'ia japë sipërmarrësit në emër të vetin. Në këtë rast, ai do të konsiderohej pronari i të gjithë kapitalit të investuar dhe përqindja e mudarabesë do të jetë e aplikueshme në totalin e fitimit. Por në situatën e tanishme, është qëllimi i mirë i ndërmarrësit ai që e jep këtë kapital ekstra dhe ai konsiderohet partner i pronarit deri në masën e shfrytëzimit të këtij qëllimi të mirë. Kjo është sepse për këtë sipërmarrësi ka të drejtë të ma-

rrë pjesë në fitim dhe humbje të kapitalit të marrë hua.

Kur ka humbje kapitali, në fund, kreditorët e parë do të paguheshin plotësisht dhe pjesa tjetër e rënies në kapital do të mbartet vetëm nga pronari.¹

Por nëse humbja është shumë e lartë, saqë kreditorët nuk mund të paguheshin plotësisht, atëherë aq sa është pamundësia për të shlyer kreditorët, humbja do të ndahet nga pronari dhe sipërmarrësi në mënyrë të barabartë. Pjesa tjetër e humbjes do të mbartet vetëm nga ana e pronarit.²

Përveç këtyre karakteristike të përmendura ne kemi mundësi të shohim edhe këtë veprimtari biznesore qysh në kohën e injorancës. Kjo formë e fitimit ka qenë i njohur që në kohën e injorancës dhe pas shpalljes së Kur'anit famëlartë i Dërguari i Allahut e miratoi këtë lloj veprimtarie dhe shokët e tij u morën mjaft me këtë veprimtari. Mirëpo, që kjo veprimtari biznesore të jetë e vlefshme, duhet të plotësohen disa kushte, ndërkaq ne këtu do të përmendim vetëm disa më të rëndësishme. Në mesin e kushteve përmendim:

- fitimi ndërmjet të dy palëve duhet të jetë sipas një përqindje të caktuar, ashtu që çdo njëri do të marrë hisen e vet. Kjo nënkupton se duhet të caktohet përqindja. Po ashtu, kjo nënkupton se fitimi nuk mund të jetë një

shumë e caktuar.

- nëse ndodhë të ketë humbje, humbjen e bart pronari i kapitalit, ndërkaq punëtori nuk ka përgjegjësi në humbje dhe nuk garanton kapitalin nëse nuk ka bërë lëshime të qëllimshme, sepse edhe punëtori ka humbur në një mënyrë, gjegjësisht e ka humbur mundin që e ka dhënë dhe nuk ka fituar kurrë nga puna që e ka bërë.³

SI VEPROJNË BANKAT ISLAME ME MUDARABAH?

Mudarebe është partneriteti mes dy apo më tepër personave kur njëri merre pjesë më kapital kurse tjetri me punë dhe aktivitet, duke u marrë vesh që profiti të ndahet mes tyre konform përqindjes së caktuar.

Humaniteti i sistemit ekonomi islam në këtë drejtim shihet në faktin se Islami e ndaloi kamatën, por hapi para myslimanëve mundësi të reja të shtimit të pasurisë dhe fitimit në mënyrë të ndershme dhe duke mos përfutur në kurriz të tjerëve.⁴

Mudaraba përfaqëson pjesëmarrjen e përbashkët të bankës islame dhe klientëve të saj në projekte të caktuara biznesore. Qëllimi i mudarabah është puna me atë që posedon kapital, por nuk posedon edhe dije, ose aftësi të udhëheq me atë kapital në projekte të caktuara dhe

3. Ekonomia islame (revistë shkencore periodike), viti 2008, nr.3, f.19

4. Karakteristikat e Sistemit Ekonomik Islam, Mr.Bashkim Aliu, Shkup 2005 f.103

në anën tjetër me atë person tjetër i cili ka aftësi dhe dituri që të veprojë me kapitalin e caktuar, por nuk ka mjete financiare për ta realizuar atë projekt. Mudareba është marrëveshje e bazuar në marrëveshjen e punës dhe të kapitalit të ofruar nga të dy palët, ndërsa të drejtë në pjesëmarrjen e fitimit kanë të dy palët kontraktuese edhe pse veprimtaritë e tyre dallojnë prej njëri tjetrit. Nuk ka mudareba përveç me ndarjen e profitit midis pjesëmarrësve. Kjo ndarje e profitit bëhet në përqindje e cila është e shënuar në marrëveshjen kontraktuese. Nuk është në rregull që të përcaktohet shumë fikse të profitit e cila duhet të paguhet për njërën palë; patjetër duhet që fitimi të shpërndahet në përqindje.

Ndërsa në rast të humbje secili humb atë që e ka investuar dhe as më shumë e as më pak. Sipas kësaj banka humb mjete të saja financiare ose materiale, ndërsa klienti humb kohën, mundin dhe kjo paraqet humbje jo materiale. Principe sipas të cilave nuk është shprehur përzierja e kapitalit veti me mudarebes me kapitalin e marrëveshjes mudarebe përfaqëson principin klasik të këtij instrumenti bankar, ndërsa mudarebe në kohën moderne ose neoklasike dominon rregulli se bankat islame duhet të shfrytëzojnë qeverisjen me kapitalin aksionar bashkërisht me kapitalin e depozitarëve të saj. Rëndësia e këtij inovacioni në sis-



temin financiar islam është e pakrahasueshme.¹

PËRFUNDIM

Nga kjo qasje e shkurt u njoftuam me përkufizimet e kësaj forme të organizimit të biznesit, mësuam mbi karakteristikat kryesore dhe në këtë mënyrë edhe aplikimin e kësaj forme në praktik. Nëse do të ishim pak më të dhënë pas rregullave të shariatit si popull, padyshim kjo formë e organizimit të biznesit në mesin tonë do të gjente përkrahje dhe do të ishte tepër e shtrirë. Islami përcakton një drejtësi universale edhe në sferën e biznesit për njerëzit.

1. Islamsko bankarstvo / Edhem Bakšić, artikull i publikuar në http://mm.co.ba/sehara/zanimljivi_tekstovi/art87.html

Mudarabah edhe pse duket si formë e shoqërisë aksionare, ajo nuk është e padrejtë ndaj personave ose palëve që marrin pjesë në të. Edhe fitimi edhe humbja në këtë formë të organizimit të biznesit ndahen bashkërisht. Sikur vetëm fitimi do të ndahej midis palëve, ndërsa humbja do i dedikohej vetëm njëres palë, atëherë do të ishim të padrejtë dhe kjo formë e organizimit të biznesit nuk do të ishte specifike.

Të shpresojmë se populli ynë më në fund do të vetëdijesohet për të hapëruar drejtë rregullave të Allahut të Plotfuqishëm.

SALIH EFENDI MYFTIJA

Salih Efendi Myftia u lind në vitin 1891 në një mjedis të shquar intelektual dhe fetar familjar që ishte tipike në mbarë Shkodrën. U rrit në qytetin tanë me një edukatë të shëndoshtë. Mësimet e para i mori në Medresenë e Shkodrës e më pas i plotësoi në Vlorë tek teologu i mirënjohur, Haxhi Vehbi Dibra, myfti i atij qyteti në atë kohë. Që moshë të re Salih Myftia zotëronte gjuhët orientale: arabishten, turqishten dhe persishten. Shpejt fitoi simpatinë e banorëve të vendlindjes dhe me sjelljen dhe përkushtimin në punë lartësoi figurën e tij prej fetari të shquar. Një kujdes të veçantë tregon për pasurimin e bibliotekës së familjes që e kishte trashëguar nga paraardhësit. Për këtë bibliotekë është shkruar në mjaft organe shtypi¹, por ne theksojmë se ajo ishte një ndër më të vjetrat e ndër më të kompletuarat me vepra fetare, filozofike e të shumë degëve tjera të shkencës, ku Sali Efendiu studionte e plotësonte formimin e tij kulturor e fetar. Për fat të keq kjo bibliotekë është zhdukur plotësisht nga vala e shkatërtimeve dhe e përndjekjeve politike komuniste ateiste.

Kultura e tij e gjerë dhe aftësitë personale e afirmuan si një drejtues fetar të merituar, prandaj edhe e emërojnë Drejtor i Medresesë së Epërme në vitin 1925. "... u hap në Shkodër një medrese e re zyrtare nën drejtimin e Salih Efendisë me mësues të aftë fetarë e disa mësues civilë të cilët jepnin mësimet suplementare..."².

Me 14 janar të vitit 1931 Salih Myftija emërohet Kryemyfti i zonës së Shkodrës³ me dekret të Mbretit Zog dhe veç Tij është firmosur edhe nga Kryeministri dhe Ministri i Drejtësisë.⁴ Pak më vonë juridiksionit të drejtimit të Salih Efendisë i shtohet edhe Prefektura e Kosovës, që përfshinte zonën: Kukës, Krumë, Has, Gjakovë (Tropojë). Këtë detyrë e kreu me përkushtim të veçantë dhe u shqua si një drejtues i aftë e kompetentë.



dorëshkrim, fq. 535.

3. Dekreti nr. 19, 14 kallnuer 1931, ruhet në arkivin e familjes Myftija

4. Faik Luliu, Islam Dizdari, Nexhmi Bushati, Në kujtim të brezave, Shkodër 1997, fq. 383.

Puna e Salih Efendi Myftisë në këtë periudhë spikatë në disa drejtime:

- Kryemyftinia e Zonës së Shkodrës dhe Kosovës riorganizohet dhe funksionon më mirë si institucion fetar, administrohen pronat e vakëfit, nxitet e kontrollon veprimtaria e institucioneve fetare dhe e përfaqësuesve të tyre në vartësi, funksionon biblioteka e pasur e vakëfit.

- Zëri i Kryemyftinisë, i hoxhallarëve të nderuar dhe i intelektualëve të shquar islamë dëgjohej i qartë dhe i fuqishëm në të gjitha strukturat organizative të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe në veprimtaritë që organizohen prej tij.

- Për të gjithë hoxhallarët e shquar krijohet një klimë e shëndoshë pune, ku nxitet dhe rritet shkalla e interesit për fenë përmes formave të menduara dhe të organizuara mirë.

- Ka një lëvizja të madhe kuadrosh nga qytete të tjera, ata gjejnë në Shkodër një pritje të ngrohtë e vijnë me kënaqësi këtu.

- Meremetohen shumë xhami dhe emërohen kuadrot më të mirë për shërbimet fetare. Hidhen themelet e ndërtimit të xhamisë së Parrucës. Për këtë xhami ndihmon edhe prefekti Javer Hurshiti i cili i ndoqi nga afër punimet⁵ Rrethohet xhamia në Fushë Çelë, bëhen dy porta hekuri me punime artistike tërheqëse. Sistemohej oborri

5. Dashnor Kaloci, Hurshiti, kaukaziani, që punoi si deputet e ministër për Shqipërinë, gazeta "Shqiptare" rubrika "Dosier", faqe 12,13, e premtë, 22 shtator 2000.

i saj dhe krijohet një parcelë e hijshme e mbjellë me ullinj. Ngrihet parku i madh i qytetit (sot parku "Luigj Gurakuqi") ish pronë e vakëfit.

- Riorganizohet mësimi i besimit islam në shkollat shtetërore, emërohen për të dhënë mësim hoxhallarët më të nderuar dhe mësuesit më të devotshëm. Ngrihen kurset e besimit pranë xhamive dhe forcohet puna e tyre.

- Nxiten familjet shkodrane që djemtë e vajzat të ndjekin shkollat e të gjitha kategorive. Gjimnazi i Shtetit tashmë bëhet një qendër me rëndësi e formimit kulturor të rinisë. Interesohet që shumë studentë që kryejnë këtë shkollë të vazhdojnë shkollat e larta jashtë vendit.

- Fillon një traditë e bukur botimesh fetare islame, sidomos në shtypshkronjën "Ora e Shkodrës", ku edhe botohet revista "Zani i Naltë" organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

- Ka një lëvizje interesante të intelektualëve shkodranë në shërbim të fesë dhe të kulturës fetare, ata botojnë artikuj e studime në shtypin e kohës.

- Ka një lëvizje të gjerë kulturore, fetare dhe kombëtare, organizohen festa në mënyrë të tillë, sa që kanë lënë mbresa të fuqishme tek banorët. Festat e bajrameve, të netëve të mëdha, hareja dhe kënaqësia e netëve të ramazanit, këndimet e mevludeve, ngritja e koreve të nxënësve dhe e orkestre frimore që i shoqërojnë ceremonitë, krijojnë një atmosferë festive që ende kujtohen sot nga të moshuarit. Një shembull tipik është organizimi i këndimit të mevludit i vitit 1934 e më vonë. Për lexuesit janë të njohura mbresat e Imam Vehbi Ismailit kur si nxënës i Medresesë së Përgjithshme mori pjesë në këtë kremtim. Këtu po citojmë një fragment nga artikulli i Zef Pashko Dedës, i cili mes tjerash shkruan: "Hirësia e tij Salih Myftia ... na la një shembull

të shkëlqyeshëm... të tolerancës dhe të mirëkuptimit sa kombëtare aq edhe fetare, kur në Shkodrën e vet historike dhe lavdiplote, pavarësisht nga periudha të zymta e rrethana të turbullta arriti ma në fund në kohën e tij qi për çdo 28 Nandor ... dhe ndër festa fetare të njërës dhe të tjetrës palë, me lidhë me flamuj të vegjël e me drita elektrike minaret e xhamive dhe ato të kishave katolike".¹

Kjo konsideratë është rrjedhojë e gjithë atij nderimi të banorëve të mbarë Shkodrës që me ligjëratat e tij dhe me oratorinë e rrallë bëri për vete zemrat e mijëra besimtarëve në të katër anët e Shqipërisë për forcën morale dhe edukuese, sepse në jetën dhe në shpirtin e Salih Efendisë, Fe e Kombësi. Shkonin çift, pa ia nxënë kurrë vendin njëra-tjetrës. Qe udhë rrëfytes i denj në punët fetare, sa c'ishte prijës i pashoq dhe pionier i shumë ndërmarrjeve kombëtare, kurdo që vendi i gjet në rrezik.

Edhe armiqtë nuk kanë mundur t'ia zbehin forcën e karakterit dhe përpjekjet e tija në rrugën e drejtë. Për këtë Llazaer Roganovic shkruan "Marko Rraganovic, duke mos dashur të mbesë prapa myslimanëve dhe katolikëve në festat e tyre, vendosi edhe ky të qesi pushkë. Në këtë moment arriti Xhandarmëria dhe arrestoi qitësin...Në këtë kohë Marko Tomë Rashkoviç shkoi shpejt në Sjhkodër tek pronari i tij, Salih Myftija dhe i tregoi ngjarjen... Ai ndërhyri që ushtria të tërhiqej nga ngjarja dhe të mos merrej asnjë masë kundër vrakacorëve..."²

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, Sali Efendiu internohet në Gjirokastrë. Lidhur me këtë fakt zotëri Adem Hoda shkruan: "... në lëmin kombëtar, me zaptimin e Shqipërisë më 7

prill 1939, qe vënë në shenj nga zaptontjesit dhe u internua në kalanë e Gjirokastrës për një kohë relativisht të gjatë".³ Ndërsa zotëri Nderim Kupi me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Salih Efendi Myftisë, thotë: "Salih Myftinë unë e njoha në vitin 1939, menjëherë mbas okupacionit, kur familja jonë ishte e internuese në Gjinokastër., atje sollën edhe Salih Efendinë. Në jetën time kam pasë rast me njofto dy fetarë të ndritur e patriotë të spikatur, Sali Myftiun dhe Padër Lek Lulin. Salih Myftiun e mbaj mend si fëmijë kur isha në Gjinokastër, ishte njeri i qetë, i matur, që kishte respekt e gjithë Gjinokastra për te".⁴

Periudha gjatë okupimit të vendit tonë nga Italia fashiste zbulon tek personi i Salih Myftisë një karakteristikë tjetër dalluese. Duke ndjerë në thellësitë e shpirtit të tij tragjedinë kombëtare dhe humbjen e lirisë, prej një besimtari të devotshëm me Kuran në dorë, kalon në një luftëtar lirie pa kompromis dhe me pushkë në krah organizon rezistencën nacionaliste shqiptare, duke u bërë në këtë mënyrë një nga inspiruesit më të dalluar të luftëtarëve të lirisë e duke u vënë plotësisht në shërbim të çështjes kombëtare. Shtëpia e tij u bë çerdhe e rezistencës antifashiste më parë dhe asaj komuniste më pas, duke vënë në dispozicion fuqinë e tij morale dhe materiale që kishte. I pajisur me edukatën fetare dhe i udhëhequr nga ideali i lartë kombëtar, kurdoherë u mundua që t'i harmonizojë shpirtat e revoltuar të nacionalizmit shqiptar e t'i bashkojë në një front të përbashkët për shpëtimin e atdheut dhe rikthimin e lirisë popullit shqiptar, duke synuar bashkëpunimin e popullit në një trevë të përbashkët etnike. Ai luajti rol kryesor në organizimin në një rezistence pasive më parë dhe

1. Zef Pashko Deda, "Jeta dhe vdekja e tij", gazeta "Atdheu", Organ i Organizatës Kombëtare "Lëvizja e legalitetit" (O.K.L.L.), New York. Vjeti XXVIII, Nr. 2 (53), Maj-Qershor 1978, fq. 3.

2. Llazar Roganoviç, Braca u braca. Tit - grad, 1978, fq. 82.

3. Ahmet Hoda, Fjala me rastin e vdekjes së Salih Myftisë, gazeta "Atdheu", nr. cituar.

4. Nderim Kupi, Intervistë dhënë Radio-Shkodrës me rastin e 100- vjetorit të lindjes së Salih Efendi Myftisë, tekstin 11 faqe daktilografim e ruan familja Myftia.

aktive më vonë, kundër fuqive të boshtit Romë-Berlin, sikur në themelimin e Organizatës Kombëtare “Besa Shqiptare”, e cila u shkri më vonë në Lëvizjen e Legalitetit. Një nga punët më me vlerë që ka ndërmarrë Hirësia e tij është themelimi i Besës Shqiptare, organizatë kjo kombëtare me aktivitet politik për rikthimin e Monarkisë në Shqipëri. Bashkëpunëtorët e Sali Myftisë në këtë veprimtari kanë qenë figura të shumta dhe të nderuara në Shkodër dhe në Shqipëri, si: Ndoc Çoba, ish Kryetar i Bashkisë së qytetit, vëllezërit Gera, Shefqet Muka, Kol Kiri, Hajdar Rusi, Rasim Boksi, Ethem Rama, Llesh Marashi, Gjelosh Luli, Ragip Lohja etj. Kjo organizatë kishte edhe organin e vet kulturorpolitik “Jehona e rinisë”, ku kanë kontribuar mjaft të rinj shkodranë.¹

Në këtë kohë pësoi një goditje tjetër nga pushtuesit, i arrestojnë djalin e madh Fuadin dhe si peng ia internojnë në kampin famëkeq të Prishtinës së bashku me një grup të rinjsh të tjerë shkodranë.

Me pushkën në krah organizon rezistencën nacionaliste shqiptare, duke u bërë njëri nga frymëzuesit më të shquar të luftëtarëve të lirisë. Ai u përpoq gjithmonë të harmonizonte shpirtat e revoltuar të nacionalizmit shqiptar, për t'i bashkuar në një front të përbashkët në shpëtimin e Shqipërisë dhe bashkimin e kombit në një trevë të përbashkët etnike.²

Në prak të ardhjes në fuqi të pushtetit komunist në Shqipëri Salih Efendi Myftia me zemër të ganduar mori rrugën e mërgimit për të mos u kthyer më kurrë në atdheun e tij të dashur, për të cilin jetoi e punoi gjatë të gjithë jetës së

tij pothuajse shekullore. I dëshpëruar deri në thellësitë e shpirtit, largohet nga atdheu duke lënë në Shkodrën e tij të dashur bashkëshorten e nderuar me tre djem e katër vajza dhe farefisën e gjerë. Duke marrë me vete djalin e madh Fuadin, mikun, bashkëluftëtarin e shokun e jetës Kolonel Xhemal Lacin se bashku me atdhetarë të tjerë të dalluar, me një barkë të vjetër hidhet në valët e Adriatikut për të kaluar në Botën e Lirë.

Largimi nga atdheu për Sali Myftiun nuk kishte kuptimin e shpëtimit, por kishte për qëllim të vazhdonte luftën e pandërprerë antikomuniste dhe rikthimin e lirisë së humbur popullit të shumëvujtur shqiptar. Në këtë luftë vazhdoi deri në minutën e fundit të jetës së tij duke na lënë si trashëgim shembullin e luftëtarit të lirisë.³

Në rrugën e mërgimit filloi një etapë tjetër e veprimtarisë fetare dhe politike e Salih Myftisë. Që në ditët e para kur ishte në kampin “Grumo” të të mërguarve shqiptarë në Bari. “Atje na lanë nja 20 ditë. Ky ishte kampi famëkeq i Grumos, ku jeta ishte më shumë se një torturë e pafund dhe kushtet tepër të këqija... Rregullat dhe disiplina ishin tepër të rrepta.. Në fillim të pranverës të vitit 1945, na çuan në kampin e Santa Maria di Leuca...”⁴ Në kushte morale dhe të një hidhërimi të thellë, ai më 28 Nëntor 1944, Ditën e Flamurit, organizon me të gjithë emigrantët shqiptarë një ceremoni atdhetare dhe fetare. Atje i lutet Zotit të Madhërueshëm për t'i ardhur në ndihmë atdheut dhe banorëve të kësaj toke të lash-të. Një fotografi kuptimplote e paraqet Sali Myftiun së bashku me mikun e tij dhe atdhetarin e njohur, Baba Rexhepin, duke u lutur. Më pas nga Bari e internojnë në një zonë tjetër, në Rexhio Emilja.⁵

3. Hysejn Mulosmani, Koha dhe vepra e tij, gazeta “Atdheu”, nr. 1 cituar.

4. Dalip Greca, intervistë, me Fuad M - ftija, gazeta “Illyria” cituar më parë.

5. Të dhëna nga emisioni i Radio-Shkodrës, dorëshkrim i cituar.

Filloi kështu një periudhë e re në jetën e Salih Myftisë, e ngjeshur me vuajtje dhe të panjohura. Ish-te një odise e mirëfilltë. Kaloi nga njëri vend i huaj në tjetrin, nga Italia në Egjipt, Siri, Liban.⁶

Gjatë qëndrimit të tij në Aleksandri, jo vetëm që u njoh dhe u çmua nga njerëzit me të lartë të rangut të vet fetar, por u pa kurdoherë me nderime të posaçme edhe në rrethet më të zgjedhura të aristokracisë së vendit e personalitetet më të njohura të botës arabe.. Në këto kontakte të nivelit të lartë ai nuk harroi kurrë të theksonte ceshtjen e lirisë kombëtare dhe u përpoq gjithnjë të krijonte për popullin e kombin tonë sa më shumë miq, përkrahës dhe simpatizantë.⁷

Në mërgim qe ndër këshilltarët më të afërm të Mbretit Zog i Parë dhe njëri që e ndihmoi më tepër në realizimin e lidhjes midis Mbretit Zog dhe krerëve të mërgatës politike shqiptare, e njohur si “Marrëveshja e Aleksandrisë”.⁸

Duke folur për mbresat nga njohja me Salih Myftiun, Z. Nderim Kupi shënon: “Ai ishte shumë i përgatitun, bile ka dhënë në atë kohë mësim edhe në Universitetin e Kajros”.⁹

Dr. Raufi, Kryetar i Qendrës Islamike Arabe në Washington, duke cilësuar Salih Myftiun thotë: “Salih Myftija ishte mendimtar i madh dhe njohës i thellë në çeshtjet fetare... ndër të gjitha rastet Hirësia e tij më bindi e më qetësoi, me qetësinë dhe kënaqësinë që sjell e vërteta, e drejta dhe arsye-timi me njerëz të kalibrit fetar e kombëtar, ishte Hirësia e tij Salih Myftia”.¹⁰

6. Shaban Vani, Udhehëqes I shquar I Myslimanëve shqiptarë në Botën e Lirë. Gazeta “Drita Islame”, e premte, 20.III.1992, nr. 6, faqë 3.

7. Zef Pashko Deda, vepër e cituar.

8. Po aty.

9. Nderim Kupi, Emision në radio Shkodra, cituar më sipër.

10. Dr. Rauf, Kryetar I Qendrës Islamike Arabe në Washington. Fjala e mbajtur në ceremonisë së varrimit të Salih Myftisë. Gazeta “Atdheu”, cituar më parë.

Mbas një përvoje të hidhur të jetës së mërgimit, që e detyroi atë të kalojë prej një vendi të huaj në tjetrin, prej Italisë në Egjipt, në Siri, dhe në Liban, më në fund Salih Efendia gjet prehje e paqe në rrethin familjar të djalit të vet Fuad dhe të Bashkësisë Shqiptare në tokën bujare të Amerikës së Washingtonit, deri në ditët e fundit të kësaj jete.

Në SHBA fillon aktiviteti i Salih Myftisë në fushën fetare. Ai pa humbur kohë merr inisiativën për themelimin e Qendrës Islame Shqiptare-Amerikane për shtetet Neë Jork-Neë Jersey dhe së bashku me imam Isa hoxhën. Hirësia e tij Salih Efendi Myftia me aftësitë e tija u bë inspiruesi dhe udhërrëfyesi për punën e mëtejshme të këshillit provizor. Kongresi i Parë i mbajtur më 16 Maj 1966 unanimisht e zgjodhi Kryetar shpirtëror dhe kryetar nderi i Qendrës Islame.¹ Me ndihmën e intelektualëve shqiptarë hapin të parën shkollë fetare-kombëtare, ku Salih Myftia, për krye moshës që kishte, nëpr vapë e nëpër të ftohtë, asistonte në çdo orë mësimi që mbahej.

Në numrin e 13 nëntorit 1972, të ditës së hënë gazeta "The New York Times" njofton se në rrugën Albermarle 1325, në zonën Flatbush të Brooklyn-it u ngrit xhamia e re e Komunitetit Mysliman të Shqiptarëve të Amerikës me iniciativën e Kryemyftisë Salih Efendi Myftia, mbi 80 vjec. Në këtë numër gazeta boton edhe dy fotografi nga ceremonia e parë fetare në këtë xhami.²

Ngritja e xhamisë, krijimi i Komunitetit Mysliman për shqiptarët e Amerikës, hapja e shkollës së parë fetare-kombëtare për fëmijët e myslimanëve të shqiptarëve të Amerikës janë dëshmi e një përkushtimi të lartë fetar e atdhetar. Në këto qendra fetare e kulturore



të gjithë shqiptarët emigrantë në Amerikë dhe Kanada takohen, njihen edukohen me ndjenjat më të larta morale islame dhe me dashurinë për atdheun e largët.

Salih Myftia krahas punës së madhe në fushën e edukimit fetar të shqiptarëve në Botën e Lirë, zhvilloi edhe një veprimtari të dendur politike atdhetare. Ai që nismëtari i krijimit të Organizatës Kombëtare "Lëvizja e Legalitetit" në mërgim. Ky personalitet i shquar, nacionalist i vendosur, luftëtar konsekuent kundër pushtimit fashist dhe regjimit komunist në Shqipëri, mendimtar dhe klerik i devotshëm, udhëheqës shpirtëror i besimtarëve myslimanë në diasporë, zgjidhet njëzëri Kryetar i parë i Komitetit Qëndror të kësaj organizate, detyrë që e mbajti me nder deri sa vidq. Në gazetën "Atdheu", organ i O.K.L.L. në muajin prill-qershor 1985, duke përkujtuar datat historike të muajit prill botohen pesë fotografi të figurave më të shquara, që lidhen me ngjarjet e këtij muaji, krahas fotografisë së Zogut I, Abaz Kupit

etj. Mes tyre është edhe fotografia e Salih Myftisë me nënshkrimin "Ish kryetar i Parë i O.K.L.L. në mërgim, Figurë e Shqueme Fetare e kombëtare".³

Për meritat e tij fetare dhe kombëtare Leka I-Mbret i Shqiptarëve e dekoroi Salih Myftiun me Dekoratën "Kordoni i madh i Skenderbeut" për merita të larta që Hirësia e tij ka në fushën e përpjekjeve tona në fushën fetare e kombëtare.⁴

Salih Myftia, në moshë të thyer, 87 vjeç, mbas një pune dhjetëra vjeçare si dishepull i atdhetarizmit dhe i fesë, ndërroi jetë.

"Gjatë tri ditëve, me 20 deri me 22 maj 1978, rreshta të pambarim bashkatdhetarësh vizituen shtëpinë mortore "Frank Campell-Funeral Home", Madison Avenue 81, Neë Jork, ku pushonte trupi i Hirësisë së tij, Sali Myftia.

Gazeta "Atdheu" i kushtoi një numër special kësaj ngjarjeje të dhimbshme.

Në Shqipëri u deshtën vitet e demokracisë që emri i këtij burri të shquar të kombit tonë të nderohej e të vlerësohej. Për këtë ai u dekorua nga Presidenti i Republikës me medaljen "Pishtar i demokracisë", u organizuan veprimtari shkencore dhe përkujtimore, u botuan artikuj e studime në organe të ndryshme.

Salih Efendi Myftia, krejtësisht i dhënë mbas ceshtjes kombëtare, na mësoi të duam cdo vëlla shqiptar si vetveten dhe Atdheun e Kombin mbi cdo gjë. Ai gjithmonë mbajti lart flamurin e bashkimit dhe të vëllazërimit kombëtar, me të cilin na printe në luftë kundër armiqve që nëprkëmbnin dhe shtypnin lirinë dhe të drejtat kombëtare. Ai tërë jetën e vet të gjatë ëndërroi bashkimin e Shqipërisë me Kosovë e me Çamëri.

1. Azem Gjidija, 20 vjetori i themelimit i Qendrës Islame Shqiptare-Amerikane për shtetet New York-New Jersey, në revistën "Përpjekja jonë, Vol.XIII-të, Prill, Maj 1987. Nr. 13-14, fq. 40.

2. The New York Times, Momndai, N - vember 13-1972.

3. Gazeta "Atdheu", viti XXXV, nr. 2 (73), prill-qershor 1985, "Datat historike të prillit në jetën e kombit shqiptar", faqe 3.

4. Dekorim i meritue, gazeta "Atdheu", nr. 50-51, New York, Nandor 1977, fq. 1.

Taxh Mahall: Simboli madhështor i artit Islam në Indi



India zotëron njërën prej shtatë mrekullive të botës Moderne, “Taxh Mahallin”, i quajtur “Margaritari i Bardhë i Indisë”. Për ta vizituar atë, do të duhet të udhëtohet drejt Agrës, rreth 200 kilometra në jug të kryeqytetit, Nju-Delhit. Agra është njëri prej qyteteve më të rëndësishme dhe më të lashta të Indisë. Zhvillimin dhe famën, që e pavdekësuan në kujtesën njerëzore, Agra e mbërriti gjatë kohës së sundimit të Shah Xhahanit.

Taxh Mahall tërheq çdo vit dy deri në katër milion turistë, 200 000 mijë prej të cilëve vijnë përtej oqeanit.

Taxh Mahall u ndërtua prej perandorit mus-

liman **Shah Xhahan** (i cili vdiq në vitin 1666), dhe është shprehja e një “ëndrre”. Taxh Mahall do të thotë Pallati i Kurorës dhe është një mauzole e cila mban varrin e mbretëreshës Mumtaz Mahallit (emri i vërtetë i mbretëreshës ishte Arxhumand Banu) në dhomën e poshtme. Më vonë këtij mauzoleu iu shtua edhe varri i Shah Xhahanit.

Ky mauzole (varr monumental) konsiderohet si përmendorja më e bukur që i është ngritur ndonjëherë dashurisë. Sipas legjendës, princi gjashtëmbëdhjetëvjeçar, i ardhshmi “Mbret i Botës” u dashurua që në shikim të parë me Arxhumand Banu Begam, e njohur me emrin Mumtaz Mahall. Vdekja e saj gjatë lindjes së

fëmijës, më 1631, e zhyti perandorin në një pikëllim që s'ka të rrëfyer, por frymëzoi ndërtimin e përmendores më të bukur që ka lartësuar dashuria e burrit për gruan e tij.

Për të pavdekësuar atë dashuri të pacak, Shah Xhahani kërkonte një arkitekt që të projektonte një varr, që nuk ishte parë kurrë më parë, ku do të preheshin eshtrat e gruas së tij të dashur. Kësisoj, mbërritën arkitektë nga të katër anët e botës, nga India e Jugut, Burma, Egjipti, Cejloni, nga Transkaukazi, nga Persia e gjetkë, po perandori mbeti i pakënaqur. Pastaj, në Oborin e perandorit, në Kështjellën e Kuqe, në Agra, mbërriti nga Turqia mjeshtrë Isai. Gojëdhëna thotë se edhe mjeshtri kishte humbur njësoj të shoqen dhe se edhe ai kërkonte një mënyrë për ta amshuar dashurinë e vet. Duke u mbështetur në faktin se arkitekt Isai ishte nga Turqia (po jo turk), se kishte qenë nxënësi i arkitektit më të madh të kohës në Turqi, mimar Sinanit, shqiptar nga Qesarati, atëherë të dhënat dokumentare të viteve të fundit, arrijnë në përfundimin se Usta Mehmet Isai ishte shqiptar nga Opari i qytetit të Korçës.

Taxh Mahalli është ndërtuar sipas një stili që kombinon element të arkitekturës persiane, indiane, dhe islamike. Në vitin 1983 Taxh Mahalli u shpall trashëgimi botërore e UNESCO –s dhe u quajt perla e artit musliman në Indi dhe një nga kryeveprat e trashëgimisë botërore (botërisht e admiruar).

Ndërkohë që kubeja e bardhë e mermerit (e mauzoleut) është komponenti më familjar, Taxh Mahalli aktualisht është një strukturë komplekse. Ndërtimi i tij filloi në vitin 1632 dhe përfundoi rreth vitit 1653 dhe u punësuan mijëra artizan dhe zejtar (ose zanatçi).

Në vitin 1631, Shah Xhahan, perandor gjatë perandorisë Mughal, periudha e lulëzimit më të madh, u pikëllua kur gruaja e tij e tretë, Mumtaz Mahall, vdiq gjatë lindjes së fëmijës së tyre të katërmbëdhjetë, Gauhara Begum. Shah Xhahan pranoi ose pëlqeu dëshirën e gruas së tij dhe ndërtimi i Taxh Mahallit filloi më 1632 një vit pas vdekjes së saj. Kronikat e oborrit mbretëror ilustrjnë legjendën e pikëllimit të Shah Xhahanit

si një inspirim për ndërtimin e Taxh Mahallit. Mauzoleu u përfundua në vitin 1648 dhe ndërtesat rreth tij dhe kopshti u përfunduan pesë vite më vonë.

Taxh Mahalli ka një doktrinë arkitekture unike. Për të mbrytur këtë vegim përrallor, u shfrytëzuan materialet më të çmuara që mund të gjenden: nga Kina u soll kristali, nga Tibeti tarkuizi, nga Afganistani lapis lazuli, nga egjipti kristoliti, nga Oqeani Indian koralet, guaskat e rralla, margaritarët, pastaj të tjera soje: topaze, onikse, safirë, rubinë, diamante etj Kështu u arrit madhështia e pagëzuar "**poezi në mermer të bardhë**". Tregohet se kur një vizitor e pyeti të shoqen se çfarë ndiente ndaj Taxh Mahallit, ajo i qenkej gjegjur: "Do kisha vdekur me gaz që sot, po të më ngrihej nesër një Taxh Mahall mbi varr".

Taxh Mahalli qëndron në një platformë katrore të ngritur me katër qoshet të këputura duke formuar kështu një tetëkëndësh të pabarabartë. Forma e arkitekturës përdor konceptin e **ndërthurjes së arabeskave**, në të cilën çdo element qëndron mbi veten e vet dhe njëkohësisht ndërthuret me ndërtesën qendrore. Për ndërtimin e kësaj ndërtese janë përdorur parimet e gjeometrisë replikuese dhe një simetri e elementeve arkitekture.

Kupola e tij qendrore është 1767.84 cm në diametër dhe ngrihet në një lartësi prej 6492.24 cm Kjo kupolë është e rrethuar prej 4 kupolash të tjera. Katër minaret madhështore janë të larta 4953 cm. Mauzoleu është pjesë e një kompleksi të madh që përfshin një portë të madhe, një kopsht shumë të bukur, një xhami në krah të majtë, një dhomë pritjeje në krah të djathtë dhe disa ndërtesa të tjera madhështore. Taxh Mahalli ndodhet në skajin më të largët të këtij kompleksi dhe lumi Jamuna gjendet mbrapa kësaj ndërtese. Kopshti i madh përmban katër pishina reflektuese që e ndajnë atë në qendër. Çdonjëra prej këtyre pjesëve është më tej e ndare në katër pjesë të tjera dhe përsëri çdonjëra prej këtyre pjesëve është përsëri në katër pjesë të tjera. Ashtu si Taxh Mahalli, edhe elementet e kopshtit shërbejnë si një arabeske, duke qëndruar mbi veten e tyre dhe



gjithashtu duke përbërë të gjithë veprën.

Në përputhje me rregullat (ndalimet) Islame kundër përdorimit të formave antropomorfe, elementët dekorativë përfshijnë kaligrafi, forma abstrakte dhe motive floreale. Përmes këtij kompleksiteti versete nga Kurani janë përdorur si elementë dekorativë. Ku përfshihen: sure Shems, Ihlas, Fexhr, Tinë, Inshirah, Jasinë, Tekvir, Intifar, Inshikak, Bejjine, Mulk, Feth, Murselat, Zumer.

Gjithashtu nëntëdhjetenëntë emrat e Allahut gjenden të përdorur si kaligrafi në anët e varrit të Mumtaz Mahall si : Hyjnori, i Madhërishmi, i Vetmi, i Përrjetshmi, i Lavdishmi etj. Në portën e madhe të hyrjes shkruhet ajeti “O shpirt i kënaqur në prehje. Kthehu tek Zoti në paqe me të dhe Ai në paqe me ty”.

Taxh Mahalli u ndërtua për një periudhë kohore prej 22 vjetësh, duke punësuar 22,000 punëtorë. Ndërtimi i kësaj vepre mbaroi në vitin 1648 dhe kushtoi **32 milionë rupish**.

Shumë shpejt pasi Taxh Mahalli u kompletua, Shah Jahan u rrëzua(hoq) nga fronin nga djali i tij Aurangzeb dhe u vendos nën arrest shtëpie afër fortesës Agra. Pas vdekjes së Shah Xhahan e varrosi atë në mauzoleu, afër gruas së tij. Nga fundi i shekullit nëntëmbëdhjetë, pjesë të ndërtesës u rrëzuan keqas nga mosmeremetimi. Gjatë kohës së rebelimit indian të vitit 1857, Taxh Mahalli u shpërftytur nga ushtarë anglez dhe nga nëpunësit e qeverisë, të cilët hoqën (daltuan përjashta) gurë të çmuar nga muret e tij. Në fundin e shekullit nëntëmbëdhjetë mëkëmbësi i mbretit të Anglisë urdhëroi një restaurim masiv, i cili përfundoi në vitin 1908. Gjatë kësaj periudhe kopshti u rimodelua me fusha me bar sipas stilit anglez të sotëm.

Për të ndihmuar kontrollin mbi ndotjet, qeveria indiane ka ngritur Zonën Trapez të Taxhit (Taj Trapez Zone) e cila përfshin 10.400 kilometër katror përreth kompleksit të Taxh Mahallit.

Kaligrafia është realizuar nga kaligrafisti persian Abdulhak, i cili erdhi nga Shirazi i Iranit. Afër ajeteve të Kuranit, në bazën e kubesë së brendshme gjendet mbishkrimi: "E shkruar nga qenia e parëndësishme Amant Khan Shirazi "

Në muret më të ultë të varrit gjenden relieve që përshkruajnë lule dhe hardhi.

Sipas një legjende të vjetër thuhet që Shah Xhahani planifikoi të ndërtonte një mauzoleu me mermer të zi përmes lumit Jamuna. Thuhet që Shah Xhahani u hoq nga fronti nga i biri shumë kohë përpara se të ndërtohej Taxh Mahalli. Rrënojat e mermerit të zi përmes lumit në Kopshtin e Dritës së Hënës duket se e mbështesin këtë legjendë. Megjithatë gjurmimet e bëra rreth viteve 1990 zbuluan se në fakt ato ishin gurë të bardhë të cilët ishin kthyer në të zi. Një teori më e besueshme për origjinën e mauzoleut të zi ishte ajo e vitit 2006 e hedhur nga arkeologët që rikonstruktuan pjesë të pishinës së Kopshtit të Dritës së Hënës. Një refleksion i errët i mauzoleut të bardhë mund të shihej lehtësisht, i përshtatshëm për obsesionin e Shah Xhahanit për simetri.

Nuk ekzistojnë dëshmi për pretendimet që përshkruajnë, shpesh herë me detaje të frikshme, vdekjet, gjymtimet dhe sakatimet që Shah Xhahani i bëri arkitektëve dhe mjeshtërve të ndryshëm që morën pjesë në ndërtimin e varrit. Disa histori pretendojnë që personat që morën pjesë në ndërtimin e Taxh Mahallit nënshkruan kontrata që nuk do të angazhoheshin apo të merrnin pjesë në ndonjë projekt të ngjashëm. Dëshmi të ngjashme janë bërë për shumë ndërtesa të famshme nëpër botë. Gjithashtu nuk ekzistojnë dëshmi për kërkesën që Lordi William Bentinck, guvernator i përgjithshëm i Indisë në vitet 1830 mendoi të shkatërronte Taxh Mahallin dhe nxori në ankand mermerin. Në vitin 2000 gjykata Lartë e Indisë hodhi poshtë peticionin që deklaronte që një mbret hindu e kishte ndërtuar Taxh Mahallin.

Kompleksi i Taxh Mahallit kufizohet në tri anët me mure me shkëmbinj të kuq, ndërsa ana nga lumi është lënë e hapur. Jashtë mureve gjinden disa mauzole plotësuese, duke përfshirë këtu ato

të grave tjera të Shah Xhahanit dhe një varr më të madh për shërbyesën e preferuar të Mumtazit. Këto struktura të bëra në radhë të parë me shkëmbinj të kuq, janë varret tipike të epokës Mughal.

Porta (hyrja) kryesore është një strukturë madhështore ndërtuar nga mermeri e cila kujton arkitekturën e perandorëve më të përparshëm.

Në fund të kompleksit, gjenden dy ndërtesa të mëdha me gurë të kuq, të cilat janë të hapura nga ana e varrit. Të dyja ndërtesat janë pasqyrim preciz i njëra-tjetrës. Ndërtesa perëndimore është një xhami dhe ajo lindorja është 'përgjigja', qëllimi (funksioni) parësor i të cilës ishte bilanci arkitekturor, megjithatë mund të jetë përdorur si një vend për pritjen e mysafireve.

Plinthe dhe varri morën afërsisht dymbëdhjetë vite për tu kompletuar ndërsa pjesët e mbetura të kompleksit si minaret, xhamia dhe portat dhjetë vite. Vlerësimi i shpenzimeve për ndërtimin e Taxh Mahallit ndryshon pikërisht nga vështirësitë për vlerësimin e shpenzimeve përgjatë kohës.

Taxh Mahalli u ndërtua duke përdorur materiale nga tërë India dhe Azia dhe mbi 1000 elefant janë përdorur për të transportuar materialet e ndërtimit.

Kopshti Charbagh, një dizajnim i inspiruar nga kopshtet persiane, u fut për herë të parë në Indi nga perandori i parë Mughal, Babur. Simbolizon katër lumenjtë që rrjedhin në Xhenet dhe pasqyron kopshtet e Xhenetit. Në tekstet mistike islame të periudhës Mughal, parajsa përshkruhej si një kopsht ideal i begatisë me katër lumenj që rrjedhin nga një burim apo mal, që e ndajnë kopshtin në veri, jug, lindje, perëndim.

Rregullat islame ndalojnë dekorimin me kujdes (me hollësi) të varreve kështu që Mumtazi dhe Shah Xhahani janë vendosur në dhomën e nëndheshme me fytyrat e tyre kthyer djathtas si dhe drejt Mekës.

KRISTALET NANOMETRIKE JAPIN SHUMË PREMTIME PËR TEKNOLOGJI DIELLORE

Shkencëtarët nga Los Alamos National Laboratory në SHBA zbuluan që dukuria e njohur si "carrier multiplication" në të cilën kristalet e gjysmëpërçuesit reagojnë ndaj fotoneve duke "shumëzuar" elektrone, ka më shumë zbatime sesa që mendohej më parë. Ky zbulim i hap dyert drejtë zbatimeve të shumta në teknologjinë e qelizave Diellore, gjë që mund të lejon ndërtimin e pllakave Diellore më efikase.

Në publikimin e tyre, shkencëtarët pohuan se kristalet e Slenid Plumbit nuk janë materiali i vetëm ku kjo dukuri paraqitet. Materialet tjera si Kadium Selenidi gjithashtu tregojnë kësi aftësi.

Zbulimi gjithashtu përmban njohuri më të thella mbi vet procesin e dukurisë. Mendohet se dukuria shkaktohet nga ekcitetimi i elektroneve përmes fotoneve por një gjë e tillë nuk është vëzhguar në materiale mikroskopike.

Zbulimet nga Los Alamos do të kenë aplikime praktike në teknologjitë fotovoltike si dhe në metodat foto-katalitike e prodhimit të hidrogjenit nga uji.

NJË LABORATOR FIZIKE NË ILINOI NË KËRKIM TË MISTEREVE TË UNIVERSIT

Një laborator fizike i ngritur dekada më parë në shtetin Ilinoi, është përfshirë kohët e fundit në një garë historike për të zbërthyer misteret e universit. Laboratori Kombëtar Fermi u hap 40 vjet më parë për eksperimente fizike. Por kohët e fundit në këtë laborator është sjellë një pajisje moderne për zbërthimin e atomit. Shkencëtarët shpresojnë se ajo do të mundësojë një zbulim revolucionar në fizikën bërthamore.

Shkencëtarët në Laboratorin Fermi të Departamentit të Energjisë e quajnë zbulimin e pritshëm "Grimca e Higsit". Laureati i Çmimit Nobel në Fizikë, Leon Lederman e quan "Grimca e Zotit." Por askush nuk e di nëse kjo grimcë përbërëse e atomit ekziston realisht. "Grimca e Higsit", që do të shpjegonte përse materia ka masë, mbetet ende një trillim teorik.

Për dekada me radhë, shkencëtarë nga e gjithë bota kanë ardhur në Laboratorin Fermi dhe kanë bërë zbulime në fizikën bërthamore që kanë çuar në teorinë e Grimcës së Higsit. Por kjo epokë kërkimesh dhe ndoshta një zbulim i ardhshëm u vunë në rrezik kur u vendos që Aksele-ratori i Grimcave Atomike të mbyllej në vitin 2011.



Pjesa më e madhe e punës për të zbuluar grimcën Higgs do të vazhdohej në një laborator fizike në Gjenevë të Zvicrës. Shtetet e Bashkuara kanë dhuruar mbi 500 milionë dollarë për këtë projekt. Por laboratori zviceran që do të merrej me këto kërkime është aktualisht i mbyllur, si rezultat i një aksidenti.

Shkencëtarët në këtë laborator janë optimistë se administrata e re amerikane do t'i japë laboratorit Fermi fondet dhe mbështetjen e nevojshme që i ka munguar prej vitesh. Ky laborator shpreson të përfitojë nga paketa stimuluese, megjithëse nuk dihet konkretisht shuma që do të veçohet për ta.

ZHVILLOHET KABLO NEURAL PËR TRANSFERIMIN E SHËNIMEVE NGA KOMPJUTERI NË TRU



Kablo i ndërtuar nga neuronet një ditë mund të përdoret për transferimin e "shënimeve" nga kompjuteri në tru të njeriut. Një kablo e tillë është zhvilluar në University of Pennsylvania në SHBA. Hulumtuesit janë të mendimit se një teknologji e tillë mund të ndihmon personave të cilët kanë humbur gjymtyrë për ta kontrolluar gjymtyrën prostetike.

Mendimi pas këtij hulumtimi është se neuronet janë më të gatshme për tu lidhur me neurone tjera, si për shembull me trurin e njeriut.

Në 2001, ekipi hulumtues arriti ta zhvillon një metodë përmes të cilës fijet neurale janë kultivuar duke i tërhequr grupet e neuroneve. Gjatësia e fijeve të tilla arrinte deri në 10 cm. Fijet e tilla janë përdor deri tani për regjenerimin e nervave të dëmtuar në gjymtyrë.


Kablo neural është prodhuar në mënyrë të ngjashme. Grupet e neuroneve janë kultivuar mbi 96 elektroda të mbuluara me protein për të cilin neuronet kapen. Kur neuronet dhe elektrodën vendosen në largësi prej 100 mikrona, qelizat fillojnë të rriten në drejtim të proteinës, duke krijuar kështu lidhje neurale.

Me tërheqjen graduale të dy pllakave (një të neuroneve dhe tjetra e elektrodave), fijet neurale vazhdojnë të rriten në distance e posa krijuar. Rritja shkon deri në 1 cm në ditë.

Doug Smith, krye hulumtuesi, thotë se "pjesën e lirë do ta përdorim për lidhje me tru, ndërsa atë tjetër për lidhje me kompjuter". Testet të cilat kanë konfirmuar se sinjalet elektrike mund të mbarten në të dy drejtimet në kablo ishin të suksesshme. Smith tani pret ta mbart testin në shtazë.

Qëllimi kryesor për përdorimin e neuroneve dhe jo të materialeve jo-biologjike është rezistenca e organizmit, e sidomos të neuroneve, ndaj metalit apo gjërave të ngjashme.

MUNGESA E VITAMINES D SHKAK PER SHUME SEMUNDJE



Zbulohen sëmundje të tjera që shkaktohen nga mungesa e vitaminës D në organizëm. Prej kohësh, shkencëtarët e dinë se mungesa e vitaminës D çon në sëmundje të kockave si rakitizmi. Por tani ata kanë gjetur edhe lidhjen që ekziston midis nivelit të ulët të vitaminës D dhe një numër sëmundjesh, përfshirë edhe kancerin. Trupi e njeriut krijon vitaminë D nëpërmjet kontaktit me rrezet e diellit, por megjithatë, rajonet me diell më të shumtë si Afrika, Azia e Lindja e Mesme kanë rastet më të shumta të njerëzve me mungesë të vitaminës D. Kjo tregon se në përfitim të kësaj vitamine luajnë rol edhe faktorë të tjerë.


Studimet e kohëve të fundit tregojnë se mungesa e vitaminës D mund të bëhet shkak për shumë sëmundje të rrezikshme, sesa mendohej më parë. Ndër këto sëmundje studimi përfshin diabetin e tipit 1, sklerozën e shumëfishtë, reumatizmin, dhe sëmundje infektive si tuberkulozi e gripi. Vitamina D kur është e mjaftueshme në organizëm pakëson rrezikun e goditjeve në zemër, e tru dhe mbi të gjitha pakëson rrezikun e prekjes nga kanceri. Por edhe dielli i tepërt mund të shtojë rrezikun e prekjes nga kanceri në lëkurë. Ekspertët thonë se në këtë rast njeriu duhet të bëjë kompromis duke qëndruar në diell në kohë të caktuar. Ata rekomandojnë që për tri javët e para njerëzit duhet të qëndrojnë drejtpërdrejt në diell për 10 minutat derisa lëkura të fitojë aftësinë për të prodhuar vitaminë D.

Tashmë të gjithë jemi koshientë për të mirat që përmban vitamina D. Ajo gjendet pothuajse kudo dhe tashmë konsiderohet si vitamina numër një. Të paktën pesë studime kanë dëshmuar për përfitimet e gjera nga kjo vitaminë, që nga ruajtja e shëndetshme e gjendjes së zemrës dhe të kockave deri tek ulja e rrezikut për kancerin e gjirit. Megjithatë, rreth gjysma e grave nuk marrin sa duhet sasi të kësaj vitamine. Shumë ekspertë janë dakord se gratë e reja duhet të marrin rreth 800 deri në 1000 mg në ditë. Mund të merrni sasinë që ju nevojitet nga ushqimet e përditshme ose të zgjidhni ushqime të pasura me vitaminë D.

SHTATE SEKRETET PËR TE MUNDUR PAGJUMËSINË

Nuk ju zë gjumi? Nëse vuani nga pagjumësia me siguri po ndiqni disa nga rregullat tradicionale për ta mposhtur këtë sëmundje: Mos pini kafe, sidomos gjatë pasdites, mos bëni aktivitete sportive gjatë natës, mbani dhomën e gjumit të ajrosur dhe në temperaturë normale dhe sigurohuni që krevati, jastëku dhe carcafet të jenë të rehatshëm.

Këto janë këshilla shumë të mira, por ka edhe disa gjera me pak të njohura që mund të provoni për të pasur më shumë orë gjumi.



1. Vendosni alarmin para gjumit

Këshillën e jep mjeku ekspert, Michael Breus u rekomandon pacientëve të tij që të vendosin alarmin një orë përpara se të shkojnë në shtrat gjë që u kujton atyre se ka filluar procesi i vepërimeve që bëjnë zakonisht njerëzit përpara se të flenë gjumë, si larja e gojës apo përgatitjet e fundit për të nesërmen.

2. Mos u përpiqni të çliroheni nga mendimet e ditës

Një nga shkaqet kryesore të pagjumësisë është ankthi dhe depresioni. Shume persona përpara se të flenë mendojnë për ankthet dhe ngjarjet që u kane ndodhur gjatë ditës dhe nuk arrijnë të flenë. Mos u përpiqni të largoni këto mendime nga mendja. Nëse ja arrini vazhdoni, por nëse jo, atëherë mos u sforconi më tej pasi s'do të bënte gjë tjetër veçse do të shtronte stresin dhe pagjumësinë.

3. Numëroni shifra dhe jo dele

Një tjetër mënyrë për të të zënë gjumi është të numërosh mbrapsht nga 300 deri në 3. Vetëm nëse jeni një as matematike, në të kundërtën s'do të arrini të përqendroheni në asgjë tjetër përveç se numërimit. Kjo do të sillte edhe largimin e mendjes nga mendimet stresuese të ditës.

4. Zgjahuni nga gjumi gjysme ore përpara

Nëse vuani nga një pagjumësi kronike, përpiquni të zgjaheni gjysme ore përpara orarit që çoheni zakonisht. Kjo funksionon pasi mësoni trupin tuaj me zgjimin më shpejt në mëngjes dhe si rrjedhojë ndiheni më i freskët gjatë ditës.

5. Mundohuni të konsultoheni me një psikolog

Një psikolog i specializuar për pagjumësinë do t'ju ndihmonte që të mundnit me shpejt pagjumësinë.

6. Mos u shqetësoni nëse nuk arrini të fleni menjëherë

Nuk duhet të mburreni nëse ju zë gjumi menjëherë sa vini kokën në jastëk. Nëse kjo ndodh shpesh, është shenjë se po flini i kapur nga stresi. Koha ideale që një person ta zërë gjumi është 15-25 minuta pasi shtrihet.

7. Shkoni në shtrat kur të ndiheni i lodhur

Nëse keni probleme të vazhdueshme me gjumin, mos u shqetësoni se është mesnate dhe se duhet të zgjaheni në orët e para të mëngjesit. Sforcimi i të ndenjuri në shtrat do të sillte vetëm rrotullime dhe përpjekje të kota. Në vend që të shtriheni, më mirë shkoni dhe bëni diçka qetësuese dhe kthehuni në shtrat kur të ndiheni i lodhur.

VENDBANIMET NE JERUSALEMIN LINDOR TENSIONOJNË LIDHJET SHBA-IZRAEL



Kohët e fundit janë vënë re disa ecejake të shtuara të diplomatëve amerikanë në Lindjen e Mesme, dhe Jerusalemi dhe vendbanimet izraelite atje kanë qenë në qendër të diskutimeve.

Tensionet midis udhëheqësve izraelitë dhe atyre amerikanë lidhur me këtë çështje janë shtuar, në ndryshim nga vitet e fundit.

Kanë kaluar 60 vjet pas krijimit të Izraelit dhe toni i retorikës me palestinezët nuk duket se ka ndryshuar aspak. Dhe pika e nxehët tani është Jerusalemi Lindor.

Ajo pjesë është pushtuar në vitin 1967 - së bashku me pjesën tjetër arabe të Bregut Perëndimor.

Javët e fundit Izraeli i ka dhënë leje një kompanie izraelite për të ndërtuar shtëpi të reja për banorët izraelitë në një rajon të vjetër palestinez, të quajtur Shepherd's Hotel.

Hagit Ofran, që punon për një grupim aktivist izraelit, Peace Now (Paqe Tani), kundërshtarë e ngritjes së vendbanimeve në tokat e pushtuara, thotë për Bc-në se kjo çështje është shumë delikate - një vendbanim i ri në qendër të një lagjeje palestineze.

Zyrtarët amerikanë kanë shprehur kohët e fundit kundërshtimin e tyre ndaj këtij projekti në takime me homologët e tyre izraelitë.

Përgjigja në shumë pjesë të izraelit ishte, indinjatë.

Lëvizja e banorëve izraelitë në rajonet palestineze nuk është diçka e re - gati 200 mijë syresh jetojnë tashmë në Jerusalemin Lindor.

Retorika atje nuk ka ndryshuar që kur të dyja palët ulën armët në vitin 1967. Ajo që ka ndryshuar këtë herë, thotë profesori për marrëdhëniet ndërkombëtare në Universitetin e Harvardit, Stephen Walt, është ajo që thotë Amerika.

Administrata Obama, në kontrast me administratën Bush apo administratën Clinton para saj, është më shumë e vendosur duke thënë se zgjerimi i mëtejshëm i vendbanimeve, përfshirë edhe e gjithë ideja e rritjes natyrale, thjesht nuk duhet të ndodhë.

Administrata Obama ka thënë se 'jo më vendbanime' do të thotë 'jo më vendbanime': jo rritje natyrale, jo vendbanime në Jerusalemin Lindor.

MBYLLEN ZYRTARISHT ZGJEDHJET NË SHQIPËRI, KQZ SHPALLI 140 MANDATET

Anëtarët e Komisionit Qendror, me një votim 7 me 0, shpallën 59 mandatet e fundit për Qarkun e Tiranës, Fierit dhe Shkodrës.

Koalicioni i djathtë i kryesuar nga PD ka marrë 70 mandate, koalicioni i majtë i kryesuar nga PS ka marrë 66 mandate dhe koalicioni i LSI-së ka marrë 4 mandate. Sipas vendimeve për Qarkun e Tiranës, 32 mandatet e qarkut më të madh të vendit ndahen në 16 mandate për koalicionin e djathtë "Aleanca e ndryshimit", drejtuar nga PD, 15 mandate për koalicionin "Bashkimi për ndryshim", drejtuar nga PS dhe 1 mandat për koalicionin "Aleanca Socialiste për Integrim", kryesuar nga LSI.

Me vendimin për këtë qark u ligjërua mandati për Kryeministrin Sali Berisha, kreun e LSI-së, Ilir Meta, dhe kreun e PR-së, Fatmir Mediu. Sa i përket Fierit, u shpallën 16 mandate që ndahen në 6 mandate për koalicionin "Aleanca e Ndryshimit", 9 mandate për koalicionin "Bashkimi për Ndryshim" dhe 1 mandat për koalicionin "Aleanca Socialiste për Integrim".

Sipas vendimit, të 11 mandatet e Qarkut të Shkodrës ndahen 7 për koalicionin e djathtë "Aleanca e ndryshimit" dhe 4 për koalicionin e majtë "Bashkimi për ndryshim". Në këtë mënyrë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve arrin që të shpallë rezultatin zgjedhor 32 ditë pas zhvillimit të tyre. Ndërsa nuk arriti që të shpallte rezultatin paraprak pasditen e 29 qershorit, për shkak të vonesave që u vunë re gjatë procesit të numërimit të votave. Për rreth tri javë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe më pas Kolegji Zgjedhor shqyrtoi një sërë ankimesh të subjekteve politike. Qarku më i kontestuar është ai i Fierit, ku fillimisht ankimoi PS për numërimin e 9 kutive të bllokuara, shoqëruar më pas me një ankimim të PD për tre kuti. I njëjti ankimim u dorëzua dhe nga PDI.

PD ankimoi sërish Qarkun e Fierit për tre qendrat ku nuk u votua. Të njëjtin ankimim bëri edhe PDI, duke kërkuar shpalljen të pavlefshme të të gjitha kutive që u numëruan në KQZ. Pas Fierit, qarqet e Tiranës, Shkodrës dhe Beratit janë kontestuar nga tre subjekte politike. Rezultati i zgjedhjeve në Tiranë u ankimua nga Partia Socialiste, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dhe Partia për të Drejtat e Njeriut, duke kërkuar rinumërim dhe rivlerësim të votave për qendra të ndryshme votimi. Rezultati i Qarkut të Shkodrës u ankimua nga Partia Demokratike, Partia Socialiste dhe Partia Demokristiane me të njëjtin objekt kërkesë ankimore. Ndërsa Qarku i Berati u ankimua nga PS, G99 dhe PR, por kërkesa e kësaj të fundit u tërhoq pak minuta para se të fillonte mbledhja e KQZ-së.

Një ankimim pati edhe për Qarkun e Lezhës nga ana e Partisë Demokratike, e cila kërkoi që rezultati i 11 kutive të këtij qarku të përfshihej në tabelën përfundimtare, kërkesë e cila u pranua. Pesë qarqe u ankimuan edhe në Kolegjin Zgjedhor, i cili shprehu vendimarrjen e tij brenda një jave, duke i shqyrtuar me radhë të gjitha kërkesë-paditë.

Tanimë, procesi zgjedhor ndodhet në hapin e fundit të tij. Pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të shpallë rezultatin përfundimtar, duke certifikuar fituesit, nisin negociatat për krijimin e qeverisë së re.